

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7602 E premte 27 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Tri ditë nga sot, Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare dhe Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar publikuan të dhënat dhe ...

Vijon në faqen 20

Nga BESNIK BAKIU

Pse ikin shqiptarët?



Opinion **i** Ditës

A varroseshin shqiptarët në kohën e socializmit? "U shtanga, por njeriu që më pyeste e kishte shumë sinqerisht pyetjen e tij. Pasi një pauzë, kurse ...

Vijon në faqen 21

Nga BEN ANDONI

A varroseshin shqiptarët?!



Përplasja/ I akuzuari: Je fundërrinë

Tentoi të abuzojë me tri vajzat, gruaja: Ish-burri më ka kërcënuar

Historia në emisionin në "News 24", denoncimi i Natashës: Nevruzi më tha "po bëj plan të të vras"

Abuzimi seksual me fëmijët është shndërruar në një realitet të dhimbshëm në botën ku jetojmë. Një ngjarje e rëndë e dhunimit është bërë publike ditën e djeshme në emisionin "Me zemër të hapur" në "News24", ku një baba ka tentuar të abuzojë seksualisht me tri vajzat. Ka qenë pikërisht nëna e fëmijëve ajo e cila ...

Në faqen 6

AMBASADA PUBLIKON PROCEDURAT PER ATA QE DUAN TE ARSIMOHEN NE AMERIKE

STUDIMET NE SHBA, JA SI TE APLIKONI

Udhëzimi për të kërkuar bursë dhe vizë studenti. Secili universitet i vendos vetë kriteret e pranimit. Bashkimi familjar në SHBA, kush e përfiton



(Në foto) Ambasada amerikane në Tiranë

Në faqen 9

"MANDELA" I KOSOVES

Ndahet nga jeta Adem Demaçi, politika: Humbje e madhe për kombin

Në faqen 4

VIZITA NE SHBA

Bushati pritet nga nënsekretari i Shtetit: Shqipëria, faktor strategjik

Në faqen 4

KRYEBASHKIAKJA

Majlinda Bufi: Një nënë e rreptë nxjerr fëmijë shembullorë

Suplement

ARTISTET

Robert Ndrenika dhe Arben Derhemi, letër Ilir Metës: Duam teatër të ri

Në faqen 18

BILANCI, 84 VIKTIMA



Zjarri në Greqi, 6 shqiptarë dalin nga spitali, 1 në gjendje të rëndë

Në 7 faqen 22

Kreshnik Beqiraj u vra nga shoku, Donjet Beqiraj: Prokuroria të zbardhë ngjarjen

E vranë me çekiç, vëllai: Urojmë të jetë gjallë

"5 muaj pas gjetjes së eshtrave nuk ka dalë ende analiza e ADN-së"

FMER- Po bëhen afro 5 muaj nga gjetja e disa eshtrave në fshatin Daullas të Fierit. Në atë kohë policia dhe prokuroria deklaruan se eshtrat i përkasin vëllait tim, Kreshnikut. Ekspertiza mjeko-ligjore konfirmoi se eshtrat janë të një mashkulli. Ndërkohë, ne



jemi krejt të paqartë në lidhje me ngjarjen, pasi ende nuk është gjetur koka dhe nuk ka dalë analiza e ADN-së. Ka kaluar gdo afat ligjor dhe nuk e dimë nëse vëllai im është gjallë apo është vranë nga personi i arrestuar, Albert Zekaj" ...

Në faqen 10

LIGJI PËR MAGJISTRATURËN

REAGIMET

Reforma në drejtësi, kryetarja e LSI-së: U kthye në betejë emrash të përveçëm

Darina Tanushi

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, akuzoi dje kryemnistin Edi Rama dhe ndërkombëtarët se reformën në drejtësi e shndërruan në një betejë personale me emra të përveçëm prokurorësh e gjykatësish. Në një deklaratë për median, Kryemadhi tha dje se, "e gjithë propaganda qeveritare për suksesin imagjinar të reformës në drejtësi nuk është gjë tjetër, veçse kambana e alarmit për kufomën e drejtësisë shqiptare, që Edi Rama dhe një grusht ndërkombëtarësh na bënë peshqesh në vend të një reforme që do të përmirësonte sistemin". Sipas saj, "ajo që nisi si një gueti shtrigash për orët dhe çantat e prokurorëve dhe gjykatësve, që duket se kishin më shumë rëndësi se bandat dhe kriminelët që ende qarkullojnë të lirë me bekimin dhe sponsorizimin personal të Edi Ramës, ajo që duhet të ishte një betejë parimore për sistemin e drejtësisë, u shndërrua në betejë personale me emra të përveçëm, që as më pak e as më shumë kishin prishur pazaret e qeveritarëve dhe jo vetëm. Pjesa dërrmuese e politikës, përfshirë edhe mua personalisht besuam dhe votuam se kjo reformë do të funksiononte. Por kë besuam realisht? Besuam Edi Ramën dhe një grusht ndërkombëtarësh që i paguhen prurësit më të parë", që sot në ikje e sipër na lanë veç standardeve të dyfishta në përzgjedhjen e atyre që mbeten apo ikin nga sistemi, një Shqipëri aspak më të mirë se ajo që gjetën kur erdhën këtu. As dhimbja false që ata ndiejnë për kolapsin ku është futur drejtësia, as dashuria po aq e shtirur për Shqipërinë nuk e mbulojnë dot me përfitimim e drejtpërdrejtë apo të ndërsjellë nga ky vend që sot lëngon nën një regjim që ka në duart e tij çdo pushtet. Plaçka e luftës që të huajt përfitojnë sa herë ky vend futet në krizë është edhe mallkimi i tyre më i madh përpara fatqesisë që i shkaktojnë këtij populli", deklaroi kryetarja e LSI-së. Ajo tha më tej në deklaratën e saj se, "e vetmja ndjesi që më jep ky proces është neveria e thellë për të gjithë ata që për vite me radhë nënëpërkëmbën dhe i përcjellin shqiptarët. Dhe këtë herë për fatqësinë në tonë, e bënë në bashkëpunim me Edi Ramën, projektuesin dhe zbatuesin e reformës kufomë të drejtësisë,

Kryemadhi: Të huajt të na ndihmojnë, jo të bëhen patericë e qeverisë "Rama"

"Asnjë reformë e blerë me paratë e drogës nuk do blejë shqiptarët"



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

DEKLARATA

"Asnjë reformë e blerë dhe e shitur me paratë e drogës, asnjë kullë e re apo e vjetër e ndërtuar me këto para nuk do mund të blejë kurrë besimin e shqiptarëve, se ky vend meriton më shumë se një reformë që gatuhet me helmim e krim të shitet si betejë parimore e atyre, që moralin e vetëm e kanë tek lidhjet e ngushta me kryeministrin dhe banditët e tij", bëri të qartë kryetarja e LSI-së.



Gjatë një seance parlamentare

Kreu i Grupit të LSI, kritika të forta ndaj misionit të BE-së

Petrit Vasili: BE në Tiranë do një Shqipëri që shkon në humbëtirë

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, lëshoi kritika në adresë të misionit të BE-së në Tiranë, sa u përket qëndrimeve që ka mbajtur në lidhje me reformën në drejtësi. "BE në Tiranë, që e do Shqipërinë më shumë se shqiptarët vetë. BE në Tiranë na ka bërë me turp të gjithë në shqiptarëve me dashurinë e saj të përvëlur" për Shqipërinë. BE në Tiranë po na 'mëson' vërtet ta duam atdheun tonë. BE në Tiranë e do Shqipërinë edhe me drogë, ndërsa ne nuk dimë ta duam atë me drogë. BE e do Shqipërinë me drejtësi të partisë në pushtet, ndërsa ne e duam me drejtësi të barabartë



për të gjithë", shkroi dje në një postim në "Facebook", Vasili. "BE në Tiranë e do Shqipërinë edhe të plaçkitur me koncesione, ndërsa ne jemi kundër vjedhjes parave publike dhe mundit e djerësisë së mijëra shqiptarëve. BE në Ti-

ranë e do Shqipërinë edhe të braktisur nga dhjetëra mijë shqiptarë, që emigrojnë në dhe të huaj, ndërsa ne duam që të gjithë shqiptarët të jetojnë në atdheun e tyre. BE në Tiranë e "do" vërtetë Shqipërinë, por atë Shqipëri, që shkon në humbëtirë, ndërsa ne nuk e duam atdheun tonë të mjeruar, pa të ardhme. Pra, BE në Tiranë më të vërtetë e do më shumë Shqipërinë se sa ne. E keqja është se ne kurrë nuk duam dhe do ta refuzojmë shumë rreptë një Shqipëri si kjo që do BE në Tiranë, edhe sikur kjo e fundit të na thotë këtë në shumë gjuhë, përfshirë këtu anglisht e sidomos kroatisht", nënvizoi Vasili.

që sot me bekimin e disa ndërkombëtarëve mendon se mund të ketë çdo pushtet në dorë. Kulaçin me helm që gatuan për shqiptarët, më kot pretendojnë se do na e servirin në tavolinë si vakt të gatshëm. Shqipëria është vend sovran dhe si e tillë, fatet e vendit i kanë në dorë vetë shqiptarët. Në rastin më të mirë, të huajt i

mirëpresim të na ndihmojnë, por jo të bëhen patericë e qeverisë së krimin e drogës. Që është pjesë e çdo raporti ndërkombëtar për zullumet e veta, por që çuditërisht vetëm disa të huaj që janë këtu nuk i lexojnë këto raporte", deklaroi Kryemadhi. Ajo shtoi në fund se: "Asnjë reformë e blerë dhe e shitur me paratë e drogës,

asnjë kullë e re apo e vjetër e ndërtuar me këto para nuk do mund të blejë kurrë besimin e shqiptarëve, se ky vend meriton më shumë se një reformë që gatuhet me helmim e krim të shitet si betejë parimore e atyre që moralin e vetëm e kanë tek lidhjet e ngushta me kryeministrin dhe banditët e tij".

DEPUTETI I PD

Boçi: Vetingu jo objektiv, Rama ka shtrirë falangat në drejtësi

Deputeti i Partisë Demokratike, Luciano Boçi, reagoi dje ndaj thirrjes së ministres së Drejtësisë, Etil-da Gjonal, për të miratuar me urgjencë ligjin e Magjistraturës. Nëpërmjet një statusi në "Facebook", Boçi ka krahasuar ministrin me "Qupën ose Çupën" te loja me letra, e cila ekziston në katër forma dhe ngjyra të ndryshme. Boçi thekson se deri para pak ditësh, ministrja e Drejtësisë e cilësonte KLD-në një "pjesë të zezë të historisë së drejtësisë", ndërsa sot kërkon që me ligj, t'i japë këtij institucioni emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj. Ndërkohë, gjatë emisionit "Intervista e Ditës" me gazetarin e "GSH", Erjon Çiku, Boçi tha se procesi i vetingut dhe rivlerësimit të gjyqtarëve nuk po bëhet në mënyrë objektive dhe kjo për shkak të ndërhyrjes së kryeministrit Edi Rama, që për opozitën po tenton të kapë sistemin e drejtësisë. Sipas deputetit demokrat, në seancat dëgjimore të vetingut deri më tani është vënë re një përzgjedhje selektive sa u përket prokurorëve dhe gjyqtarëve që kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit. Boçi thekson se ka gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët janë kapur me mosdeklarim të saktë të pasurisë, apo pikëpyetje lidhur me pastërtinë e figurës së tyre, të cilët sërish kanë arritur të kalojnë vetingun. Në një kohë, ku po për të njëjtat pasaktësi, shumë gjyqtarë dhe prokurorë janë shkarkuar. Deputeti i PD-së nënvizon se kjo po bëhet me ndërhyrjen e kryeministrit Rama, që sipas tij ka shtrirë falangat edhe në sistemin e drejtësisë, i cili pa Gjykatën Kushtetuese dhe atë të Lartë rrezikon të shkojë në kolaps. Për Boçin, shembull i tillë është edhe ligji për Shkollën e Magjistraturës, për të cilin thotë është një hap më tej i qeverisë për të kapur drejtësinë. Luciano Boçi thekson se nga ana e saj PD nuk po përpiqet të bllokoi reformën në drejtësi, por vetëm ta bëjë atë një proces objektiv, duke iu përmbytur marrëveshjes së korrikut të dy viteve më parë.



Shkolla e Magjistraturës, kreu i Grupit të PS: Morëm garanci nga Merkel

Balla pret deputetin gjerman: Opozita të hartojë amendamentin, ne e votojmë

Nicholas Lobel: Reformat duan kohë, por institucionet të funksionojnë

Darina Tanushi

Kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së Taulant Balla propozoi dje, një mënyrë konsensusi për opozitën sa i përket ligjit për shkollën e Magjistraturës. Në një konferencë të përbashkët me deputetin gjerman Nicholas Lobel, Balla u shpreh: "Ne rishprehim gatishmërinë tonë se, që në seancën e parë të 3 shtatorit, pasi dielli dhe vera të ketë qetësuar sadopak shpirtërat dhe mendjet e trazuarat të opozitës, vendimi i parë, të cilin duhet të votojmë së bashku, bashkë me PD dhe LSI është pikërisht mundësimi i pranimeve të reja në Shkollën e Magjistraturës për të mos vonuar një vit djem dhe vajza ekselentë që kanë studiuar Drejtësi e që përmeshin kriteret, por që sigurisht do të kalojnë në konkursin profesional, me qëllim që 50 ndër ta të vijojnë studimet në Magjistraturë". "Besoj që kjo rishprehje nga ana jonë e kësaj gatishmërie përmban në vetvete edhe propozimin tonë të bërë për përfaqësuesit e opozitës, le ta shkruajnë ata amendamentin dhe ne do ta votojmë. Është një moment i rëndësishëm në rrugën tonë drejt Bashkimit Europian", deklaroi Balla, i pyetur nga gazetarët. Balla tha se gjatë takimit me deputetin gjerman e ka informuar për zhvillimet e fundit politike në vend dhe e ka falënderuar për mbështetjen e Gjermanisë në procesin e integritimit evropian, por edhe në procesin e vështirë të reformave që po ndërmerr mazhoranca. "Në fakt, diskutuam edhe për bojkotin e opozitës në seancat e fundit duke bllokuar edhe vijimin e punës së Shkollës së Magjistraturës. Lidhur me reformën zgjedhore e garantova përfaqësuesin e Bundestagut gjerman, sepse për transparencë të publikut është Bundestagu gjerman që ka një vëmendje të veçantë, për miratimin dhe implementimin e menjëhershëm të rekomandimeve të OSBE/ODIHR", tha Balla.



Kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së Taulant Balla me deputetin gjerman Nicholas Lobel, gjatë konferencës për shtyp

dhe pozitive të konstatohen në zhvillimin ekonomik, në stabilitetin politik, në reformën në drejtësi, në luftën ndaj korrupsionit dhe krimin të organizuar, por edhe në reformën zgjedhore së cilës Gjermania i kushton një rëndësi shumë të madhe. Po ashtu edhe përfshirjen në reformën në drejtësi të ashtuquajturave kërkesa të Kopenhagënit dhe mendoj që deri tani Shqipëria është në një rrugë të mirë. Në një rrugë të mirë për ecuritë dhe vijimin drejt perspektivës europiane", theksoi Lobel. Ai deklaroi se duhen çuar përpara reformat. "Ne përfaqësohemi në këtë fushë me 50 ekspertë ndërkombëtarë, të cilët kanë të drejtë që të jenë këtu që të këqyrin këtë proces reformash, por edhe të influencojnë në të lidhur me skanimin e gjyqtarëve, gjyqtareve, prokurorëve, prokurorëve. Reforma në drejtësi dhe procesi i vetingut është një gur i rëndësishëm themeli në mënyrë që rezultatet e arritura dhe performanca e Shqipërisë të jenë të qëndrueshme", tha deputeti gjerman. I pyetur në lidhje me vakancat në Gjykatën Kushtetuese e të Lartë, Lobel tha se "ndonjëherë reformat në shtetin e drejtësisë janë reforma që marrin kohën e tyre dhe zgjasin shumë. Reforma në drejtësi dhe institucionet e drejtësisë janë shtylla e një shteti funksionues demokratik dhe për të arritur që të jenë shtyllë e një shteti demokratik, mbase ndonjëherë reformat që ndërmerren janë të gjata dhe të thella. Por një shtet demokratik që të funksionojë duhet të ketë edhe institucione dhe instrumente në mënyrë që të funksionojë". Ndërsa kreu i Grupit të PS-së, Taulant Balla, i pyetur në lidhje me vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit deklaroi: "Mua më vjen keq që Partia Demokratike merr përsipër të kompromentojë vendimet e KPK apo në të ardhmen, ndoshta edhe ato të apelimit, por Partia Socialiste nuk do të bëhet asnjëherë pjesë e çdo lloj komentit ndaj një institucioni tërësisht të pavarur, ku të drejtën e monitorimit në shqiptarët, në ligjëvënësit e Kuvendit të Shqipërisë të gjithë në unanimitet të plotë, 140 nga 140, ja kemi dhënë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të cilët gjej rastin t'i falënderoj".

GARANCI NGA MERKEL

"Para pak javësh në takimin me kancelaren gjermane, Angela Merkel, morëm garancitë për të asistuar më tej implementimin e reformës në drejtësi, që ka të bëjë pikërisht me një kujdes të veçantë të qeverisë gjermane për sa i përket Shkollës së Magjistraturës", -tha dje, Balla.

Bashkëkryetari socialist: Depolitizim i administratës zgjedhore

Reforma zgjedhore, Bledi Çuçi: Drafti do të jetë gati në shtator

Ndryshimet në Kodin Zgjedhor do të jenë gati në shtator. Ndonëse me vonesë pasi afati për të përfunduar ishte muaji korrik, bashkëkryetari i komisionit të posaçëm për reformën zgjedhore, Bledi Çuçi është shprehur tashmë se janë në fazën e hartimit të draftit. Bashkëkryetari i këtij komisioni, Bledi Çuçi, tha se janë ata që do të bëjnë gati draftin që do të diskutohet e do të dërgohet për vendimmarrje në parlament. "Këtu përfshihet gjetja e një mënyre për depolitizimin e administratës zgjedhore, mënyrën e financimit të partive, shpenzimet në fushatë. Pra, të gjitha këto që janë pjesë e rekomandimeve të ODHIR do adresohen", u shpreh Çuçi, në një prononcim për Abc News. Në fakt, afati për ta finalizuar reformën zgjedhore ishte korriku. Por ndonëse kjo kërkesë e kreu të prezencës së OSBE-së në Tiranë nuk u përmbush nga komisioni i posaçëm, socialisti Çuçi thotë se do të bëhet e mundur që në zgjedhjet vendore të vitit të ardhshëm në një bashki që ende nuk është përzgjedhur të pilotohet identifikimi elektronik i zgjedhësve. "Brenda qendrës së votimit, pra duke shmangur një proces që do kërkonte përdorimin e teknologjisë online, pra nuk do të ketë teknologji online, por brenda qendrës së votimit do të përdorim teknologji që do bëjë të mundur që të ruajë dhe formën tradicionale të votimit", -u shpreh Çuçi. Sa i përket votimit të emigrantëve, kjo është një temë ende në fazë diskutimi nga bashkëkryetari socialist i komisionit të reformës zgjedhore. "Çështja e ndryshimeve kushtetuese lidhet me një çështje të ndryshimit të sistemit elektoral dhe çështjet e ndryshimit sistemit elektoral tani nuk është një çështje për diskutim në komisionin parlamentar për reformën zgjedhore", -u shpreh Çuçi.



Ish-presidenti Nishani: Gjykata Kushtetuese është asgjësuar, synohet kontrolli i drejtësisë

Ish-presidenti Bujar Nishani deklaroi se Gjykata Kushtetuese është asgjësuar, ndërsa kujton shprehjet për pinokun. Përmes një statusi në "Facebook" Nishani shpjegon edhe arsyen se pse është asgjësuar Kushtetuesja, ndërsa shton se të rinj të korruptuar po vijnë. Teksa sulmon mazhorancën, ish-kreu i shtetit shkruan se synimi i qeverisë është që të kontrollojë drejtësinë përmes politikaneve të korruptuar.

"Gënjeshtria i ka këmbët e shkurtra dhe hundën e gjatë. Kjo është e vjetër sa bota. Gjykata Kushtetuese është asgjësuar; JO se kanë ikur të korruptuarit, por se nuk po vijnë të rinjtë", tha dje, Nishani. "Synimi nuk ishte pastrimi nga korrupsioni, por kontrolli i drejtësisë nga politikanët e korruptuar dhe të lidhur me krimin e organizuar.

Gënjeshtarë, shqiptarët nuk janë dele. Zullumqarët nuk duan drejtësi të vërtetë. Ata e duan si më 1945", u shpreh ish-presidenti, Nishani.



përket marrjes së vendimit lidhur me fillimin e procesit të negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Europian. Europa është një bindje dhe për të krijuar këtë bindje nuk duhet bindur vetëm Gjermania, por të gjitha shtetet anëtare për dhënien e perspektivës Europiane për Shqipërinë". "Për këtë është caktuar një plan kohor, i cili konstaton atë që në pranverën e vitit 2019 do të jetë Komisioni Europian, i cili do të paraqesë një raport progresi lidhur me Shqipërinë dhe

në varësi të këtij progres-raporti do të merrret edhe vendimi në muajt e mëtejshëm të pranverës 2019", sqaroi Lobel. "Viti 2019 është një vit shumë i rëndësishëm për Shqipërinë, vit për të cilin po punojmë së bashku për iniciimin e bisedimeve për në Bashkimin Europian. Por është një vit, i cili është i mbushur plot me sfida dhe për përballimin e këtyre sfidave jemi duke punuar së bashku me Shqipërinë, me qeverinë shqiptare, me kryeministrin Edi Rama, në mënyrë që zhvillimet e mira

Në bazën detare të Kepit të Palit në Durrës, një pjesë e efektivëve të Forcave të Armatosura, që angazhohen në rastet e fatkeqësive dhe emergjencave ekspozuan djem, mjetet dhe pajisjet që ata kanë në dispozicion. Ministria e Mbrojtjes, e pranishme në këtë paraqitje e nisi fjalën e saj duke ngushëlluar popullin grek për katastrofën e shkaktoar ditët e fundit nga zjarret, dhe njoftoi për ndihmën e ofruar nga Forcat e Armatosura shqiptare për autoritetet greke, kryesisht për kërkim - shpëtimin. Katastrofën në Greqi, ministria Xhaçka e konsideroi ngjarje, nga e cila, duhet të nxjerrim mësimë nga ku

"Katastrofa në Greqi, FA ofroi ndihmë në kërkim-shpëtim"

Emergjencat civile, Xhaçka: 6000 efektivë në gatishmëri edhe kur të tjerët pushojnë

gjithsecili duhet të kuptojë përgjegjësitë e veta, personale apo institucionale. Gjithashtu, ministria Xhaçka përmendi gjithë angazhimet e Forcave të Armatosura gjatë muajve të fundit, si dhe siguroi se ato janë të përgatitura dhe mbeten në gatishmëri për t'u gjendur pranë qytetarëve në çdo situatë. "Duhet të sigurojmë qeverinë e Shqipërisë, qoftë çdo qytetar

shqiptar se edhe Ministria e Mbrojtjes edhe Forcat tona të Armatosura që kanë sot mbi vete përgjegjësinë për përballjen me Emergjencat Civile, do të vijojnë të angazhohen edhe do të jenë pranë komunitetit për çdo lloj kërcënimi ndaj sigurisë së tyre. Jam sot këtu për t'u ofruar siguri dhe garanci se Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armato-

sura janë në çdo kohë të gatshme për të vepruar. Edhe kur të tjerët dorëzohen, edhe kur të tjerët pushojnë siç është muaji i gushtit, Forcat tona të Armatosura janë në gatishmëri dhe në krye të detyrës. Dhe ky është mesazhi që desha të përcillim sot"-Xhaçka kërkoi vëmendjen dhe kujdesin e qytetarëve dhe pushtetit vendor që në këtë sezon të verës të kenë



Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka, dje në bazën detare të Kepit të Palit në Durrës

kujdes. "Çdo veprim abuziv, i kryer nga pakujdesia, apo më keq akoma, me paramendim apo nga keqdashja, do të marrë ndëshkimin e duhur nga organet përkatëse. Dhe kemi marrë të gjitha masat që çdo

rast i evidentuar si i tillë, çdo rast, çdo zjarrvnie e qëllimshme për të folur më troç, do të marrë përgjigjen e merituar dhe dëgjuesin e të përballet me drejtësinë",- deklaroi ministria.

Ministri i Jashtëm në Ministerialin për "Liritë fetare"

Bushati pritet nga nënsekretari amerikan: Shqipëria, faktor strategjik në rajon

Stephen Mull: "SHBA, me fat që ka miq të tillë"

Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme gjendet në Washington DC për të marrë pjesë në Ministerialin mbi "Lirinë fetare" me ftesë të Sekretarit të Shtetit, Mike Pompeo. Gjatë qëndrimit në Washington DC, Ministri Bushati zhvilloi një takim me Nënsekretarin e Shtetit për Çështjet Politike, Stephen Mull. Në takimin me Nënsekretarin Mull, Ministri Bushati vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të SHBA-ve për sa i përket zbatimit të reformave të brendshme e kryesisht asaj në gjyqësor, si dhe në garantimin e sigurisë e stabilitetit në rajonin e Ballkanit. SHBA-të duhet të vazhdojnë të jenë prezentë në BP theksoi Bushati, jo vetëm si faktor paqëje dhe sigurie, por dhe si kundërbalancues i ndikimit të fuqive të treta në rajon. Nga ana e tij, Nënsekretari Mull falënderoi Shqipërinë për kontributin e çmuar si në kuadër të NATO-s ashtu dhe si faktor konstruktiv në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Nënsekretari Mull theksoi rëndësinë strategjike që SHBA-të i japin integritetit të Shqipërisë në BE dhe vazhdimin të zbatimit të reformave të brendshme. Nënsekretari Mull njoheu po ashtu Ministrin Bushati me mesazhet kryesore të Samitit të Helsinkit si dhe me pikëpamjet e Departamentit të Shtetit mbi zhvillimet më të fundit në Bashkimin Europian. Nënsekretari i Shtetit për Çështjet Politike, në Departamentin e Shtetit shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin e SHBA-ve për partneritetin me Shqipërinë. "Këtë javë pata kënaqësinë të takoj Ministrin e Jashtëm të Shqipërisë, Ditmir Bushati në Washington për të diskutuar kontributin e madh të Shqipërisë në komunitetin Transatlantik. SHBA është me fat që ka miq të tillë", shkruan Mull në Twitter pas takimit me ministrin e Jashtëm, Ditmir Bushati. Ministri Bushati zhvilloi dhe një takim me Senatorin Roger Wicker, Kryetari i Komisionit OSCE-Helsinki.



Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme në Uashington DC

Ambasadori austriak: Duhet luftë ndaj korrupsionit edhe në nivele të larta

Austria e mbështet hapjen e negociatave me Shqipërinë, Apor Bashkimi Europian kërkon fakte se ky vend po lufton korrupsionin dhe krimin e organizuar në nivele të larta. Deklarata vjen nga ambasadori i Austrisë në Shqipëri Johann Sattler për emisionin "Diplomaticus" të gazetarit Erion Kaçorri në televizionin "News 24". "Konkluzionet e Këshillit të BE-së janë më se të qarta. Kur vjen çështja të Shqipëria kushtet dihen mirë, Lufta kundër krimit të organizuar që shkon në nivele të larta. BE kërkon fakte dhe emra. Kemi parë gjatë viteve të kaluara disa përpjekje të mira, por kanë qenë kryesisht të nivelit të ulët apo të mesëm. Duam të shohim që kjo luftë bëhet në nivelet e larta. E njëjta kërkese është edhe sa i përket korrupsionit. Ka disa padi dhe denime, por janë të nivelit të ulët apo të mesëm. Nevojitet që të kalohet në nivelet e larta"-deklaroi ambasadori austriak.

Ndarja nga jeta e Adem Demaçit, politika shqiptare: Humbje për kombin shqiptar

Ka ndërruar jetë në moshën 82-vjeçare aktivisti i shquar nga Kosova, Adem Demaçi. Lajmin për vdekjen e Demaçit e ka bërë të ditur nënkryetari i Kuvendit të Kosovë Xhavit Haliti, gjatë seancës ku ishte duke u diskutuar për dialogun me Serbinë. Pasi është mbajtur një minutë heshtje në nderim të aktivistit të njohur, seanca e Kuvendit të Kosovës është ndërprerë për të rinisur sot. Adem Demaçi u lind më 26 shkurt të vitit 1936. Ai është dënuar me njëzet e tetë vite burg në kohën e ish-Jugosllavisë dhe ka mb-rojtur të drejtat e shqiptarëve dhe Kosovës. Demaçi ishte gazetar e shkrimtar; politikan e aktivist për të drejtat e njeriut. Pas ndarjes nga jeta të aktivistit të shquar nga Kosova, Adem Demaçi, në moshën 82-vjeçare, politika shqiptare ka shprehur ngushëllimet. Presidenti Ilir Meta, kryeministri Edi Rama, kryetari i PD, Lulzim Basha apo dhe kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi, shprehën keqardhje për këtë humbje.



"Të tronditur si rrallë herë në jetë, ju dërgojmë ngushëllimet tona për humbjen e Ademit të shtrenjtë, mikut të pazëvendësueshëm, të domosdoshëm si rrallëkush për ne dhe për kombin".

"Jam thellësisht i hidhëruar nga lajmi i ndarjes nga jeta të emblemsë së qëndrësës shqiptare, Adem Demaçi. Patrioti Adem Demaçi mbetet frymëzim për të gjitha brezat e shqiptarëve, një shembull dhe një model kombëtar i skulpturuar në historinë e shqiptarëve dhe të luftës kombëtare për pavarësinë e Kosovës", shkroi dje, Meta. "Me vdekjen e Adem Demaçit mbyllet historia e jashtëzakonshme e një rebeli të llojit më të rrallë; shqiptar i llojit më të mirë, burrë i llojit më të veçantë, mik i llojit më të lartë. Pas një jete prej stuhie pambarim, ai u tret ngadalë e iku si zotnia që i tha të gjitha. Respekt!", u shpreh

Rama. Kreu i PD-së, Lulzim Bash u shpreh se "Adem Demaçi si një ndër simbolet e qëndrësës kombëtare, mbetet përherë në kujtesën e kombit që përkulet me mirënjohje të thellë para sakrificës dhe kontributit të tij të pavdekshëm për Kosovën". Edhe kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi tha: "Adem Demaçi, tribun popullor, vigan i lirisë. Na dha forcën për të luftuar për lirinë. Na dha kurajën për t'i rezistuar të keqes. Na dha vizionin për të ndri-cuar të ardhmen. Na dha talentin për të ndërtuar Kosovën e lirë. Ademi na dha mençurinë e tolerancën për të falur".

SHPLLJE ANKANDI
Datë 31.07.2018, Ora 16:00
Shoqëria Përbarimorë "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Muharram Hysen Greca: Banesë dykloshme me sipërfaqe 203,33 m², nr. i ndodhur në zonën kadastrale 6190, Vendi i deklaruar pranë Drejtorisë së ALUZINI Tiranë Jug me nr. 428 datë 28.08.2006, adresë: Rruga "3 Vellëzërit Korçë", Tiranë.
Çmimi fillestar i ankandit të tretë është në shumën 4 311 075 (katër milion e treqind e njëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e pesë) lekë.
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

SHPLLJE ANKANDI
Datë 01.08.2018, Ora 16:30
Shoqëria Përbarimorë "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të debitorit shoqëria "ALSION" sh.p.k: "Ngjës" me sipërfaqe 300 m², nr. i pasurisë 15/392-N1, zona kadastrale 8523, vol. 38, faqe 4, adresë: Llogja "Syria Dygjen", Elbasan.
Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 25 200 000 (njëzet e pesë milion e dyqind mijë) lekë.
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

SHPLLJE ANKANDI
Datë 01.08.2018, Ora 16:00
Shoqëria Përbarimorë "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të debitorit shoqëria "VIGAND Konstruktion" sh.p.k: "Ngjës" me sipërfaqe 265,22 m², nr. i pasurisë 8/440-N12, zona kadastrale 8150, vol. 47, faqe 208, adresë: Rruga "Petro Nini Luarasi", Tiranë.
Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 237 637 (dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë) EUR.
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

Dyshohet për akuzën e korrupsionit pasiv, prokuroria: I shkaktuan 50 milionë euro dëm shtetit

Abuzimet me rrugën Tiranë-Elbasan, lirohet nga burgu ish-drejtori i ARRSH, Dashamir Xhika

"Arrest shtëpie" për ish-zyrтарin, shkak gjendja jo e mirë shëndetësore

Dashamir Xhika, ish-kreu i Autoritetit Rrugor u lirua nga qelitë e paraburgimit me vendim të gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Ish-zyrtari u arrestua 6 muaj më parë pasi dyshohet për abuzime me fondet e rrugës Tiranë-Elbasan. Ditën e martë Gjykata e Apelit i ndryshoi masën e sigurisë nga arrest me burg në arrest shtëpie, me argumentimin se ish-zyrtari nuk ndodhet në gjendje të mirë shëndetësore. Gjithashtu, në vendim theksohet se Xhika nuk është person me rrezikshmëri shoqërore dhe nuk ka mundësi që të prishë hetimet e për këto arsye duhet t'i zbutet masa e sigurisë. Në këto rrethana, gjykatësja Ilirjana Olldashi firmosi për ndryshimin e masës në "arrest shtëpie", në pritje për t'u përballur me gjykatën. Ish-kreu i Autoritetit Shqiptar të Rrugëve u prangos bashkë me disa zyrtarë të tjerë në muajin shkurt. Më herët Gjykata për Krime të Rënda caktoi masën e sigurisë "arrest me burg" për ish-drejtorin e Përgjithshëm të Rrugëve dhe dy vartësit e tij, Albens Alite dhe Aksel Qurduka, të dyshuar për abuzime me fondet e rrugës Tiranë-Elbasan. Sipas prokurorisë, tre zyrtarët në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë bërë të paktën 12 amendime të kontratës fillestare, duke i shkaktuar shtetit një dëm prej afro 50 milion euro.

HETIMI
Ndaj Dashamir Xhikës dhe dy ish-zyrtarëve të tjerë Albens Alite dhe Aksel Qurduka rëndojnë akuzat e



VENDIMI

Ditën e martë Gjykata e Apelit i ndryshoi masën e sigurisë nga arrest me burg në arrest shtëpie, me argumentimin se ish-zyrtari nuk ndodhet në gjendje të mirë shëndetësore. Gjithashtu, në vendim theksohet se Xhika nuk është person me rrezikshmëri shoqërore dhe nuk ka mundësi që të prishë hetimet e për këto arsye duhet t'i zbutet masa e sigurisë.

shpërdorimit të detyrës, kryer në bashkëpunim dhe korrupsionit pasiv të zyrtarëve të lartë, pasi dyshohet për abuzime me fondet e rrugës Tiranë-Elbasan, si pasojë e të cilave i është shkaktuar

buxhetit të shtetit, një dëm prej 50 milionë euro. Edhe KLSH zbuloi shkelje në vitin 2016 për rrugën Tiranë-Elbasan dhe keqmenaxhim të projektit, por Ministria e Transporteve nuk mori

masa. Në dosjen e prokurorisë thuhet se tre ish-zyrtarët në shkelje të detyrës dhe të ligjit, me veprime dhe mosveprime konkrete, me nënshkrime të amendimeve të kontratës për ndërtimin e rrugës, i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm buxhetit të shtetit. Gjithashtu, theksohet se tre ish-zyrtarët kanë likuiduar punime të kontraktuara më parë, kanë krijuar vonesa në vendimmarrjet për zgjidhjet teknike, dhe kanë pasur raste kur vlera e projektit të kontraktuar është më e

AKUZA

Ndaj Dashamir Xhikës rëndojnë akuzat e shpërdorimit të detyrës, kryer në bashkëpunim dhe korrupsionit pasiv të zyrtarëve të lartë, pasi dyshohet për abuzime me fondet e rrugës Tiranë-Elbasan, si pasojë e të cilave i është shkaktuar buxheti të shtetit, një dëm prej 50 milionë euro.

ushtruar detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH-së në periudhën tetor 2013-shtator 2017, është i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës", thuhet në urdhrin e arrestit të lëshuar nga Gjykata për Xhikën më 1 shkurt. Ndërsa mëngjesin e 2 shkurtit u arrestuan edhe 5 personat e tjerë. "Nga hetimet e kryera ka rezultuar se këta shtetas, sipas detyrave dhe funksioneve që kanë pasur, kanë kryer veprime dhe mosveprime të kundërligjshme, që kanë sjellë si pasojë shpërdorimin e fondeve publike në shumën rreth 50 milion euro, të dhëna nga buxheti i shtetit për realizimin e objektit "Sistemi asfaltim rruga e Gjinarit", dhe objekti nuk është realizuar", thuhet në vendimin e gjykatës. Në kuadër të hetimit ndaj Xhikës, në Prokurorinë për Krime të Rënda kanë dhënë shpjegime dy ish-ministrit e Transporteve nga radhët e LSI-së, Edmond Haxhinasto dhe Sokol Dervishi, ministri aktual Gjyknuri dhe njëjt zyrtarë e ish-zyrtarë të lartë.

Më datë 30 korrik jepet vendimi për kandidatin për KLGJ

Vetingu, në "sitë" gjykatësi Bledar Abdullahi, KPK: Bashkëjetuesja, s'justifikon pasurinë



Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

dhe 100 mijë lekë aksione në një shoqëri në likuidim e sipër. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se partnerja e gjyqtarit e ka përfituar apartamentin dhe garazhin përmes një kontrate shkëmbimi me të motrën. Është konstatuar, gjithashtu, se ajo kishte lidhur fillimisht një kontratë porosie për blerjen e një apartamenti, një

zyre dhe një garazhi në vlerën e 192 mijë eurove. Fillimisht ajo kishte paguar 101 mijë euro, por më pas kontrata e sipërmarrjes është revokuar, për shkak se kompania nuk ka përmbushur detyrimet e saj. Për transakcionin e mësipërm komisioni ka përlogaritur se bashkëjetuesja ka pasur mungesë burimesh financiare.

SEANCA

Në seancën dëgjimore trupa gjyqësore është shprehur se gjyqtari Abdullahi nuk ka deklaruar investimet në një fond privat pensionesh nga prindërit e tij. Subjekti rezultoi të ketë qenë i saktë në deklarimin e pasurive të tjera, siç janë pjesët takuese në një apartament, sipërfaqe tokë dhe ulishteje në Kutalli të Beratit.

Gjykatësi Abdullahi i asistuar edhe nga avokati Artan Hajdari deklaruan përpara trupës gjyqësore se bashkëjetuesja ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të justifikuar pasurinë e saj. Në përfundim, gjykatësi i karrierës kërkoi konfirmimin në detyrë. Vendimi për të pritet të shpallet me datë 30 korrik.

KPK e konfirmoi në detyrë, ONM ankimon vendimin për gjyqtarin Bashkim Dedja

Kreu i Gjykatës Kushtetuese Bashkim Dedja, i cili u konfirmua në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe kaloi vetingun tani do të kalojë në një tjetër hallkë. Atij do t'i duhet që të përballë dhe me Komisionin e Posaçëm të Apelit (KPA). Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit ka paraqitur ditën e djeshme një shkresë ku kërkon që kreu i Gjykatës Kushtetuese duhet të kryer sërish rivlerësimin e tij. Sipas Komisionerit Publik, provat nuk arrijnë në nivel të besueshëm. Më herët gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar më datë 8 qershor u konstatua se Bashkim Dedja nuk justifikonte një shumë prej 15 mijë eurosh. Të cilën e kishte marrë hua nga vëllai i tij. Sipas KPK-së, Dedja kishte paqartësi dhe para të pajustificuara në deklaratat e pasurive. Ato kanë të bëjnë me huatë për blerjen e një apartamenti në Tiranë, me sipërfaqe 146 metra katrorë. Relatorja e komisionit, Xhensila Pine tha se është kryer hetim për deklarimet e pasurisë së Bashkim Dedes: "Apartamenti banimi 146 m katror, garazh me vlerë 118 mijë euro. Burimi i këtyre aseteve janë kredi bankare 120 mijë euro me afat 20 vjet. Hua pa interes 25 mijë euro. Të ardhurat e tij, 35 mijë euro bashkë me bashkëshorten. Vlera e apartamenti është 180 mijë euro". Bashkim Dedja ka bërë dy deklaratat materiale të dyshimita: 15 mijë euro hua nga vëllai, 25 mijë euro për të cilat deklaroi se ia kishte marrë kunatit, e më pas babait të kunatit. Probleme janë vërejtur edhe me pronësinë e një apartamenti 98 metra katrorë në Tiranë, i cili është dhënë në vitin 2003 në bashkëpronësi mes Dedjes dhe njërit prej vëllezërve të tij, në masën 50 me 50. Më pas, Dedja, në deklaratën për logarit të vetingut, ka deklaruar se apartamenti është i tiji 100%. Në lidhje me këtë, avokati sqaroi se vëllai i gjyqtarit, Mensur Dedja nuk ka marrë kurrë në jetën e tij kredi, por apartamentin e tij e ka vënë si kolateral në emër të nipit të tij.

Policia: Dyshohet se është lejuar kalimi i mallrave pa kontroll

Lejonin hyrjen e pijeve kontrabandë, arrestohen tre doganierë në Kapshticë



Malli i sekuestruar

KAPSHITICË. Tre doganierë kanë rënë në pranga ditën e djeshme, pasi akuzohen për shpërdorim detyre. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se mes të arrestuarve janë edhe tre persona të tjerë, të cilët akuzohen për kontrabandë. Të njëjtat burime sqaruan se është sekuestruar një sasi pijesh të dyshuara si kontrabandë, për të cilat tre doganierët dyshohet se kanë lejuar kalimin e tyre, pa ushtruar kontrollin përkatës. Konkretisht në pranga ranë shtetasit F.G. 46 vjeç, banues në Tiranë; K. N. 34 vjeç, banues në Devoll; R. M. 33 vjeç, ban-

OPERACIONI

Shtetasi Mario Berberi, dyshohet të jetë porositi i këtij malli. Nga verifikimet e kryera, rezultoi se këto mjete kanë kaluar nga Pika e Kalimit Kufitar Kapshticë, ku dyshohet se nuk i janë nënshtruar procesit përkatës të kontrollit doganor. Materialet në ngarkim të tyre i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

Bilisht-Korçë, në afërsi të fshatit Dishnicë, nga shërbimet e Policisë, janë kapur në flagrancë shtetasit Kristi Meslani dhe Rezart Shega, të cilët drejtonin mjetet me targa AA 170 UF dhe AA 226 GH, duke transportuar një sasi të konsiderueshme me pije energjike dhe pije të tjera, të dyshuara si kontrabandë, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale. Ndërsa shtetasi Mar-

ues në Pogradec, (të tre me detyrë doganier në Pikën e Kalimit Kufitar Kapshticë). Si dhe shtetasit Kristi Meslani, 23 vjeç, banues në

Devoll; Rezart Shega, 29 vjeç, banues në Devoll; Mario Berberi, 26 vjeç, banues në Devoll. Arrestimi i tyre u bë pasi, në aksin rrugor

io Berberi, dyshohet të jetë porositi i këtij malli. Nga verifikimet e kryera, rezultoi se këto mjete kanë kaluar nga Pika e Kalimit Kufitar Kapshticë, ku dyshohet

se nuk i janë nënshtruar procesit përkatës të kontrollit doganor. Materialet në ngarkim të tyre i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

Natasha: Denonconi rastet e abuzimeve seksuale. Ish-bashkëshorti mohon akuzat: Je fundërrinë

Tentoi të abuzonte me 3 vajzat, gruaja: Ish-burri më kërcënoi, më tha: Po bëj plan të të vras

"Kemi urdhër mbrojtje, nuk mund të jetojë në një qytet me ne"

A buzimi seksual me fëmijët është shndërruar në një realitet të dhimbshëm në botën ku jetojmë. Një ngjarje e rëndë e dhunimit është bërë publike ditën e djeshme në emisionin "Me zemër të hapur" në "News24", ku një baba ka tentuar të abuzojë seksualisht me tri vajzat.

Ka qenë pikërisht nëna e fëmijëve ajo e cila ka rrefyer të vërtetën e hidhur. Mes tronditjes së thellë, Natasha tregoi momentin kur zbuloi ngjarjen e rëndë dhe masat që mori për të mbrojtur fëmijët e saj. Nëna e 6 fëmijëve nga dy martesat ka bërë denoncinimin në polici dhe çështja është në hetim. Pavarësisht se ngjarja vijon të jetë në hetim që prej 2013-ës, ajo pohoi se nuk do të ndalet me kaq, ndërsa jep mesazhin e fortë "denonconi rastet e abuzimeve seksuale". "Të gjithë ngjarjen e rëndë e zbuluam në vitin 2013. Kur më treguan vajzat, e takova diku jashtë. Ai ma mohoi ngjarjen. Por kërkoi që të bashkoheshim. Dhe unë i thash që nëse të pranoj, i bie që jam si ty. Edhe në video që janë të regjistruara, ai duket që prek fëmijët në vende intime", tha nëna e 6 fëmijëve.



Nëna e 6 fëmijëve në "News 24"

ai. Sakaq, Natasha shprehet se është e trembur nga fakti se ish-burri e ka kërcënuar me jetë, atë dhe fëmijët.

HISTORIA

Mes tronditjes, Natasha tregoi se në vitin 1994 u divorcua nga bashkëshorti i saj, pasi dashuria mes tyre kishte mbaruar; dhe nëna e tre fëmijëve të asaj kohe, dy vajzave dhe një djali u dashura në vitin 1994 me Nevruz Herri- inspektor krimesh në atë kohë në qytetin e Elbasanit. Nuk ishte e lehtë për të dyja familjet, pasi dhe Nevruzi u divorcua nga nusja e tij, pasi dashuronte Natashën. Ata u martuan bashkë dhe sollën në jetë vajzën e parë në vitin 1995, pas tre vitesh vjen në jetë dhe vajza e dytë e tyre. Edhe pse kishin sjellë dy fëmijë, familjet e tyre këmbëngulnin që ata të ndaheshin. Për shumë vite Natasha nuk fliste me familjarët e saj, madje as në varrimin e nënës së saj nuk ka qenë, pasi familja nuk ia falte divorcin dhe martesën që bëri me Nevruzin. Në rrethana të tilla, çifti u

detyrua në vitin 1998 të emigronte drejtë Belgjikës, ku në atë kohë Natasha ishte shtatzënë me djalin (në muajin e 5-të). Ajo udhëtoi në mënyrë ilegale me gomone.

Ata u vendosën në Hasell të Belgjikës dhe kërkuan azil ku dhe e fitojnë. Pas disa kohesh, Natasha përpos tre fëmijëve që kishte me Nevruzin mori në Belgjikë dhe tre fëmijët e saj nga martesat e parë, dhe si një nënë e realizuar kur bashkoi familjen me ndonjë prej këmbëngulmëturin dhe po e jetonte atë. Ajo punonte me orë të zgjatura, ku të ardhurat që fituan i shpenzuan për blerjen e një shtëpie. Gjithçka u përmbys me 1 maj të vitit 2013

kur një nga vajzat që kishte sjellë në jetë me Nevruzin i tregoi se babai kishte tentuar të abuzonte shumë herë me atë. Por situata rëndohet akoma më shumë, ku dhe dy vajzat nga martesat e parë i rrefejnë nënës së tyre se Nevruzi kishte tentuar të abuzonte edhe me ato kur jetonin në Shqipëri. E tronditur, e shokuar, Natasha e merr bashkëshortin e saj në një ambient jashtë shtëpisë për t'i kërkuar atij të vërtetën. Por ai e mohon dhe largohet nga shtëpia përgjithmonë. Nëna e 6 fëmijëve nga dy martesat ka bërë denoncinimin në polici dhe çështja është në hetim në shtetin belg.

NGJARJA

"Të gjithë ngjarjen e rëndë e zbuluam në vitin 2013. Kur më treguan vajzat, e takova diku jashtë. Ai ma mohoi ngjarjen. Por kërkoi që të bashkoheshim. Dhe unë i thashë se nëse të pranoj, i bie që jam si ty. Edhe në video që janë të regjistruara, ai duket që prek fëmijët në vende intime", tha nëna e 6 fëmijëve.

SHKURT

Vodhi klienten në zyrën e dietologes, bie në pranga 55-vjeçari nga Tirana

Policia e Tiranës ka vënë në pranga ditën e djeshme 55-vjeçarim Durim Sema, pasi dyshohet të jetë autori i grabitjes së ndodhur në zyrën e një dietologeje në Tiranë, ku një person ka vjedhur portofolin e një klienteje. Pas këtij rastit, 55-vjeçari Sema ka tentuar të vjedhë edhe një shtetas tjetër në ambientet e një agjencie, po në kryeqytet. Gjithashtu, nga veprimet hetimore të kryera rezultoi se ky shtetas është autor edhe i tri vjedhjeve të tjera të ndodhura më parë në Tiranë. "Ky shtetas në rrugën "Themistokli Gërmenji", në zyrat e një agjencie ka tentuar të vjedhë shtetasin N. S., ndërkohë që po një ditë më parë në rrugën "Bridgata 8", në një dyqan dietologjik, i ka vjedhur portofolin shtetasit V.T. Nga veprimet e kryera hetimore rezultoi se ky shtetas është autor edhe i tri vjedhjeve të tjera.

Shërr për makinën mes dy të rinjve, të shtëna me armë te Tregu Elektrik

Të shtëna me armë zjarri janë regjistruar mëngjesin e djeshëm tek zona e Tregut Elektrik, në rrugën "Vath Koreshi" në Tiranë. Sipas njoftimit të policisë së Tiranës, rreth orës 09:30 minuta në rrugën "Vath Koreshi" personi me inicialet K. K., për shkak të një konflikti me një tjetër person ka gjuajtur dy herë në ajër me një pistoletë zhurmuese, dhe më pas është larguar nga vendngjarja. Banorët kanë lajmëruar menjëherë policinë, e cila ka mbërritur në vendngjarje, ndërsa ka gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale dy gëzhoja të qitura nga pistoletë zhurmuese. Shkak i të shtënavës te Tregu Elektrik ka qenë shërr për rrugën. Personi që është në kërkim, K.K. mësohet se i ka kërkuar personit me të cilit u konfliktua që t'i hapte rrugën, ky i fundit i ka thënë se ai ka të drejtë kalimi. Të rinjtë kanë afëruar makinat me njëri-tjetrin më pas K.K. ka nxjerrë pistoletën dhe ka qëlluar. Policia po punon për arrestimin e autorit dhe zbardhjen e plotë të ngjarjes.

Shitje me Ankand te Pare nga Studio Permbarrimore L.D.C

"Apartament", me sip. 69.2 m2, Nr pasurisë 10/158+2-1, te ndodhur ne Zonen Kadestrate Nr. 8631, Vol. 9, Faqe 90, me adrese Lagjia Skenderbeg, Shk. 2, Kati 1, Ap. 1. Prona eshte e regjistruar prane Z.V.R.P.P Lezhe, ne emer te Luizim Kros Beqiri. Çmimi fillestar per shitje eshte 3.100.000 Leke.

Data e shpalljes 05.07.2018

Data e zhvillimit 31.07.2018 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbarrimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARRIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 3/438+2-53, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 36, FAQE 37, SIPERFAQE 103 M2, ZONAKADASTRALE 8380, TIRANË, NË PRONESI TE Z. ALBAN QEMAL BALA.

ÇMIMI 12.016.000 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 08.08.2018 .

CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Gjermania financon projektin me 440 mijë euro

Skema e re e granteve për sipërmarrjen, Ahmetaj: Mundësi punësimi për moshat e reja

PROGRAMI

"Projekt "IDEA" është një mundësi që i ofrohet moshave të reja nga 19 deri në 34 vjeç. Po të shikoni sfidën që ka ekonomia shqiptare është promovimi i punësimit të dy grupeve, të cilat janë akoma larg pritshmërisë në aspektin e punësimit, pra moshat 19-34 vjeç, dhe moshat mbi 50 vjeç. Ky program shkon drejtpërsëdrejti në thelb të objektivit të qeverisë për të promovuar këto kategori e për të marrë pjesë aktive në mundësitë e punësimit", -tha Ahmetaj.



Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Arben Ahmetaj

Ditën e djeshme, është paraqitur skema e granteve për sipërmarrjen. Ky prezantim është bërë nga ministri i Ekonomisë dhe Financave, Arben Ahmetaj, i cili në fjalën e tij ka theksuar se programi "IDEA" do t'u japë mbështetje sipërmarrjeve të reja. Ndërkohë ministri më tej bëri me dije se programi do t'u japë mbështetje moshave të reja, nga 19 deri në 34 vjeç. "Programi "IDEA" do t'u ofrojë mbështetje sipërmarrësve të rinj. Kjo skemë grantesh është financuar nga shteti gjerman në bashkëpunim me Ministrinë e Financave në vendin tonë e synon të mbështesë dhjetëra ide in-

ovative. Prioritet në këtë skemë do të kenë ndërmarrjet, të cilat mbështetin punësimin të rinjtë e moshave 19-34 vjeç. "Projekt "IDEA" është një mundësi që i ofrohet moshave të reja nga 19 deri në

34 vjeç. Po të shikoni sfidën që ka ekonomia shqiptare është promovimi i punësimit të dy grupeve, të cilat janë akoma larg pritshmërisë në aspektin e punësimit, pra moshat 19-34 vjeç, dhe moshat mbi 50 vjeç.

Ky program shkon drejtpërsëdrejti në thelb të objektivit të qeverisë për të promovuar këto kategori e për të marrë pjesë aktive në mundësitë e punësimit", -tha Ahmetaj në fjalën e tij. Ndërkohë ky i fun-

dit bëri me dije, gjithashtu, se nëpërmjet kësaj mbështetjeje qeveria gjermane ka vënë në dispozicion një fond prej 440 mijë eurosh dhe synon të sigurojë të paktën 110 grante për sipërmarrësit e rinj, por dhe

ata ekzistues, duke siguruar në këtë mënyrë hapjen e 110 bizneseve. Me projektin e ri, qeveria synon të hapë 140 vende të reja pune dhe njëkohësisht fuqizimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

Voltiza Duro

Brenda vitit 2017-të, plot 547 baballarë të siguruar kanë përfutur nga leja e lindjes. Kjo shifër është bërë me dije ditën e djeshme nga kreu i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Astrit Hado, i cili ka theksuar më tej se këta baballarë kanë fituar të drejtën e lejes së lindjes pasi nënat e fëmijëve nuk kanë pasur mundësi të qëndrojnë në shtëpi. "547 baballarë përfitojnë nga leja e lindjes! Jo vetëm nënat, por edhe baballarët, që janë të siguruar, kanë të drejtën e përfitimit të lejes së lindjes! Reforma në fushën e sigurimeve shoqërore ua mundëson këtë. Ndaj, gjatë vitit 2017, rreth 547 prej tyre, nga 117 që ishin gjatë vitit 2016, kanë përfutur nga kjo e drejtë, në pamundësi që nënat, për arsye objektive, të qëndrojnë në shtëpi, pas 63 ditëve të lindjes. ISSH, siguri e të ardhmes tuaj!", -ka thënë Hado.

KUSHTET DHE DOKUMENTACIONI

E ardhura për barrëllindje i paguhet gruas së siguruar për barrën dhe lindjen e fëmijës, kur ajo ka 12 muaj periudhë sigurimi, për çdo rast përfitimi. Vlen të theksohet se përjashtohet nga rregulli për periudhën e sigurimit rasti kur e drejta e pagesës për barrëllindjen e radhës ndodh brenda 24 muajve nga data e lindjes së fëmijës së mëparshëm. Sipas ISSH-së, periudha e përfitimit do të jetë 365 ditë kalendrike, duke përfshirë një minimum prej 35 ditësh para dhe 63 ditësh pas lindjes së fëmijës. Për gruan që do të ketë në barrë më shumë se një fëmijë, periudha e përfitimit do të jetë 390 ditë kalendrike, duke përfshirë një minimum prej 60 ditësh para dhe 63 ditësh pas lindjes së fëmijëve. "E ardhura për barrëllindje për gruan e siguruar është: 80 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerësuar neto të dymbëdhjetë muajve të fundit nga data e lindjes së të drejtës për pagesë për periudhën e paralindjes dhe për 150 ditë kalendrike pas lindjes; b) 50 për qind e mesatares ditore të bazës së vlerë-

ISSH: Sa ditë mund të qëndroni në shtëpi pas lindjes së fëmijës. Masa e të ardhurave që iu takon

Astrit Hado: Leja e lindjes, përfitojnë 547 baballarë të siguruar

Kriteret dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë aplikantët



NUMRI I PERFITUESVE

"547 baballarë përfitojnë nga leja e lindjes! Jo vetëm nënat, por edhe baballarët, që janë të siguruar, kanë të drejtën e përfitimit të lejes së lindjes! ", -ka thënë kreu i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Astrit Hado.

suar neto të dymbëdhjetë muajve të fundit nga data e lindjes së të drejtës për pagesë për periudhën tjetër në vazhdim", -thekson Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Ndërkohë e ardhura për barrëllindje për gratë e siguruara

së të vetëpunësuarat në bujqësi llogaritet sipas pikës 3, të këtij neni. Për periudhën deri në barazimin e kontributeve që paguajnë të vetëpunësuarit në aktivitetet jobuqësore, e ardhura për barrëllind-

DOKUMENTACIONI

Për të vetëpunësuarin në qytet

- Raportet e paralindjes dhe pas lindjes.
- Vërtetimi i pagës bruto/neto të një viti më parë nga data e lindjes së të drejtës
- Certifikatë martesë
- Certifikatë familjare.
- Certifikatë lindje të fëmijës
- Fotokopje të licencës, ose të dokumentit të lëshuar nga QKR-ja.

Për të vetëpunësuarin në qytet

- Raportet
- Vërtetimi i pagës bruto/neto të një viti më parë nga data e lindjes së të drejtës
- Vërtetim që nuk vazhdon më aktivitetin
- Certifikatë familjare
- Certifikatë lindje të fëmijës
- Fotokopje të licencës ose të dokumentit të lëshuar nga QKR-ja.
- Fotokopje të Kartës së Identitetit.
- Vërtetim vjetërsie për nënën e fëmijës nga subjekti ku punon ose nga zyra e punës.

je caktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Ndërkaj, nëna, që birëson fëmijën e moshës deri në 1 vjeç dhe që ka qenë e siguruar jo më pak se 12 muaj, ka të drejtë për leja pas lindjes, e cila fillon ditën e birësimit, por jo më parë se mbas ditës së 63-të të lindjes së fëmijës, dhe vazhdon jo më shumë se 330 ditë nga dita e lindjes së fëmijës. Minimumi i lejes për birësuesin është 28 ditë. ISSH bën me dije se kur një fëmijë është birësuar gjatë lejes së lindjes, nëna që ka lindur do të ketë një periudhë përfitimi deri në ditën e birësimit, por jo më pak se 63 ditë pas lindjes. Pas periudhës prej 63 ditësh pas lindjes, të drejtën e

lejes për kujdes ndaj fëmijës e ka edhe babai ose birësuesi i siguruar, nëse këtë të drejtë nuk e ushtron apo nuk ka kushte për ta përfutur nëna. Shpërblim për lindje fëmije i paguhet një personi të siguruar, i cili është nëna ose babai i një fëmije që lind, me kusht që njëri prej tyre të ketë kontribuar për një vit para lindjes së fëmijës. "Shpërblimi do të bëhet i pagueshëm vetëm një herë dhe nëna do të ketë përparësi në përfitimin e pagesës, në rast se ajo është e siguruar. Shpërblimi për çdo fëmijë të lindur do të jetë një shumë e barabartë me 50 përqind të pagës minimale mujore", -bën me dije ISSH.



Tregu i sigurimeve, rritje me 3.93% krahasuar me vitin 2017

Në gjashtë muajt e parë të 2018-2ë, tregu i sigurimeve ka njozur një rritje të ndjeshme krahasuar me një vit më parë. Sipas të dhënave më të fundit nga Agjencia e Mbikëqyrjes Financiare, të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-qershor 2018 kapën vlerën e rreth 7.7 miliardë lekë, ose 3.93% më shumë se në periudhën janar-qershor 2017. Gjatë periudhës janar-qershor 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 570,783 me një rritje prej 8.33% krahasuar me periudhën janar-qershor 2017. Ndërkohë, sigurimet e Jo-Jetës vazhdojnë të mbeten produkti më i preferuar, me 92.50% të vëllimit të përgjithshëm të primeve. Sigurimet e Jetës zënë 7.43% të tregut dhe vepërimtarinë e risigurimit 0.07%. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39.82% të tregut, ndërsa primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 60.18% të totalit të tregut. Nga ana tjetër, gjatë periudhës janar-qershor 2018, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 2.2 miliardë lekë, ose 15.47% më pak se në periudhën janar-qershor 2017.

KONTROLI SPITALOR SHKELJET

Voltiza Duro

Gjatë viteve 2016 dhe 2017, Spitali Universitar i Traumës, ka shpenzuar plot 212 milionë lekë për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore, në kundërshtim me ligjin. Në këtë të fundit theksohet se është detyrë e Ministrisë së Shëndetësisë që të kryejë procesin e blerjes së medikamenteve. Të dhënat janë bërë publike nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili gjatë auditimit në këtë spital ka zbuluar shkeljet tronditëse dhe ka kërkuar menjëherë nisjen e hetimeve nga Prokuroria e Tiranës. Ndërkohë gjatë mbikëqyrjes, KLSH ka arritur të zbardhë edhe shkelje të tjera të bëra nga ky spital. Sipas raportit përfundimtar janë konstatuar probleme për sa i përket koncesionit të sterilizimit të instrumenteve kirurgjikalë, për të cilin Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, vetëm për periudhën shtator-dhjetor 2017 ka paguar 81 milionë lekë. Kontrolli i Lartë i Shtetit bën me dije me tej se Spitali Universitar i Traumës, deri më tani nuk ka bërë asnjë konfirmim apo monitorim lidhur me numrin e ndërhyrjeve kirurgjikalë të kryera apo llojet e ndërhyrjeve. Kështu kontrata e koncesionit është shkelur pasi për shërbimet e sipërpërmendura, është koncesionari që paguhet nga FSDKSH-ja. Por gjatë auditimit në këtë spital është zbuluar, gjithashtu, se pajisjet mjekësore dhe të hotelerisë, që arrijnë vlerën prej rreth 707 milionë lekësh janë futur në magazinë pa cmime dhe pa faturë shitjeje. Ndërkaq, KLSH bën me dije se janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive në vlerën e rreth 50 milionë lekësh, pa u zbatuar procedura ligjore e parashikuar nga Ministria e Financave.

SHKELJET NË SPITALIN E SHKODRËS

K Kontrolli i Lartë i Shtetit, pas auditimit që ka kryer në Spitalin Rajonal të Shkodrës ka zbuluar se ky i fundit i ka shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik mbi 20.5 milionë lekë. Në raport theksohet se janë konstatuar shkelje të rënda për sa i përket menaxhimit të fondeve dhe shpenzimeve. Ky spital edhe pse ka pasur shërbimin e pandërprerë të dializës deri në 2016 ku rezultoi dhe regjistri i fundit i pacientëve, e ka kaluar këtë shërbim tek privati me urdhër të Ministrisë së Shëndetësisë. Si rezultat pajisjet ekzistuese të hemodializës, rezultojnë se janë lënë të mbyllura tek reparti i vjetër i Hemo-Dializës dhe janë jashtë funksionit, për arsye të braktisjes dhe jo për arsye të mosfunksionimit. Vlera fillestare e investimit të kryer në vitin 2005, për repartin e Hemo-Dializës së është mbi 22 milionë lekë dhe

Raporti/ Plot 212 milionë lekë për blerjen e medikamenteve, në kundërshtim me ligjin

KLSH "gozhdon" spitalin e Traumës dhe Rajonalin e Shkodrës

Zbardhet abuzimi me miliona lekë gjatë 2016-2017-ës



ABUZIMET

Një tjetër shkelje e konstatuar ka të bëjmë me pagesë më të madhe se sa ishte kontrata për ikonstrukcionin e reanimacionit. Abuzime ky spital ka kryer edhe në blerjen e medikamenteve për kimioterapinë në vlerën e 800 mijë lekëve. Pagesat për largimet nga puna pa të drejtë i kanë shkaktuar dëm buxhetit të shtetit në vlerën e 6.2 milionë lekë.

SHKELJET ME FONDET

Spitali i Traumës

►Ka shpenzuar plot 212 milionë lekë për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore, në kundërshtim me ligjin.

►Janë konstatuar probleme për sa i përket koncesionit të sterilizimit të instrumenteve kirurgjikalë, për të cilin Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, vetëm për periudhën shtator-dhjetor 2017 ka paguar 81 milion lekë.

►Spitali Universitar i Traumës, deri më tani nuk ka bërë asnjë konfirmim apo monitorim lidhur me numrin e ndërhyrjeve kirurgjikalë të kryera apo llojet e ndërhyrjeve.

►Pajisjet mjekësore dhe të hotelerisë, që arrijnë vlerën prej rreth 707 milion lekësh janë futur në magazinë pa cmime dhe pa faturë shitjeje.

Spitali i Shkodrës

►I ka shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik mbi 20.5 milionë lekë.

►Ky spital edhe pse ka pasur shërbimin e pandërprerë të dializës deri në 2016 ku rezultoi dhe regjistri i fundit i pacientëve, e ka kaluar këtë shërbim tek private

njëkohësisht duke llogaritur amortizimin në vite, vlera e makinerive mjekësore të Hemo-Dializës së vjetër, në momentin e abandonimit të tyre është mbi 11 milionë lekë. Sipas KLSH-së drejtori i Spitalit Rajonal duhet që të njoftonte ministrinë për ekzistencën e këtij reparti. Një tjetër shkelje e konstatuar ka të bëjmë me pagesë më të madhe se sa ishte kontrata për rikonstrukcionin e reanimacionit. Abuzime ky spital ka kryer edhe në blerjen e medikamenteve për kimioterapinë në vlerën e 800 mijë le-

këve.

Pagesat për largimet nga puna pa të drejtë i kanë shkaktuar një dëm buxhetit të shtetit në vlerën e 6.2 milionë lekë. Deri në fund të 2017 janë akumuluar një sasi e konsiderueshme e medikamenteve të skuadurave me vlerë 49.7 milionë lekë. Për të gjitha këto shkelje KLSH ka rekomanduar gjithsej 35 masa organizative, 10 masa për shpërbim dëmi dhe 13 masa disiplinore. Ndërkohë që është bërë edhe kallëzim penal në prokurori për ish-drejtorin e spitalit të Shkodrës.

81

MILIONË LEKË KONCESIONI

Sipas raportit përfundimtar janë konstatuar probleme për sa i përket koncesionit të sterilizimit të instrumenteve kirurgjikalë, për të cilin Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, vetëm për periudhën shtator-dhjetor 2017 ka paguar 81 milionë lekë.

K Kontrolli i Lartë i Shtetit, pas auditimit që ka kryer në Spitalin Rajonal të Shkodrës ka zbuluar se ky i fundit i ka shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik mbi 20.5 milionë lekë.

"Tu vihet fre abuzimeve, kontrolli i veçantë nga AKU"

Ushqimet në kopshte e spitale, Peleshi: Fituesit e tenderëve të kenë licenca

Të gjithë ata operatorë ekonomikë që do të fitojnë tenderët e ushqimeve në çerdhe, shkolla apo spitale duhet të disponojnë licenca dhe certifikime të veçanta. Në këtë mënyrë do të garantohet një siguri më e lartë dhe mbrojtje e konsumatorit. Ditën e djeshme Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me Agjencinë e Prokurimit Publik, çka parashikon standardizimin e specifikimeve teknike për produktet ushqimore, të cilat prokurohen nëpërmjet procedurave të prokurimit nga autoritetet kontraktore, në këto institucione. "Ky bashkëpunim, kjo marrëveshje bashkëpunimi, synon pikërisht t'i vërë fre nga njëra abuzuesve me tregtimin e këtyre llojeve produkteve, duke forcuar pra bashkëpunimin, duke instaluar një set stan-



dardesh ligjore, të cilat vetëm në qoftë se plotësohen nga subjektet, mund t'i jepet drita jeshile për të marrë pjesë në prokurimin publik, në tenderë publikë, për furnizimin e këtyre institucioneve. Nuk dua tani të fus në merak askënd, por duhet ta them që kontrolli i AKU-së për këtë kategori subjektësh dhe operatorësh do të jetë i posaçëm" tha Peleshi në fjalën e tij. Ndërkaq, sipas Drejtores së Përgjithshme të APP-së, Agjencia e Prokurimit Publik

angazhohet të marrë përsipër informimin periodik për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit me listën e operatorëve ekonomikë që lidhin kontrata publike me autoritetet kontraktore, nëpërmjet procedurave të prokurimit publik. "Qëllimi në vetvete është marrja e një produkti ashtu siç e duam dhe në rastin konkret marrja e ushqimit me cilësinë e kërkuar. Faza e para është ajo e vendosjes së standardeve, se si do t'i hartojmë kriteret e duhura që ofertesit të na japin produktin e duhur, dhe për këtë në bashkëpunim të ngushtë me AKU-në do të marrim standardet bazë që vendos legjislacioni i fushës dhe në respektim të legjislacionit të prokurimit do të krijohet kriteret bazë të cilat do të jenë të detyrueshme për çdo institucion tenderues", u shpreh kreu i APP-së.

Bashkimi familjar në Amerikë, kush e përfiton. Llojet e vizave imigruese

Voltiza Duro

Studimet në SHBA, ja kur duhet të hyni në tokën e premtuar

Ambasada: Kujdes, tregojini autoriteteve formularin I-20

Të gjithë shqiptarët që dëshirojnë të studiojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duhet të bëjnë kujdes që të hyjnë në tokën e premtuar para datës së fillimit që tregohet në formularin I-20. Ditën e djeshme, ambasada amerikane në Tiranë, nëpërmjet një njoftimi në faqen e saj zyrtare i ka bërë thirrje të gjithë të interesuarve që t'i tregojnë autoriteteve këtë formular në momentin që do të hyjnë në SHBA. "Sigurohuni që të hyni në SHBA përpara datës së fillimit që tregohet në formularin tuaj I-20 dhe mbajeni formularin I-20 në bagazhin e dorës kur udhëtoni. Autoritetet duhet ta shohin I-20-en në pikën e hyrjes në SHBA. Nëse keni një vizë studentore, Kenny duam të dëgjojmë gjithçka rreth shkollës që do të ndiqni dhe pse e zgjidhët atë shkollë! "- theksojnë ekspertët e ambasadës.

KUSHTET

Cdo vit një numër i konsiderueshëm maturantësh dhe studentësh nga Shqipëria kërkojnë në ndjekin studimet Bachelor dhe Master në USA. Në këto universitete mund të aplikojë çdo i interesuar që përmbush kriteret e pranimit të vendosura nga vetë institucioni i arsimit të lartë ku do të vazhdojë studimet. Secili universitet apo kolegji i vendos vetë kriteret e pranimit dhe afatet e aplikimit. Prandaj hapi i parë është përzgjedhja e universitetit për të ditur çdo informacion në lidhje me këtë të fundit. Aplikantët duhet të njohin paraprakisht kriteret e pranimit për fusha të ndryshme studimi. Së pari, të interesuarit duhet të shqyrtojnë alternativën më të mirë për arsimim e më tej të përfundojnë dokumentacionin për aplikim. Pas kësaj aplikantët duhet të financojnë studimet duke aplikuar për bursë e më tej duke aplikuar për vizë studentit. Pas plotësimit të hapave të pikave të mësipërme studentët duhet të përgatisin udhëtimin për në USA. Instruktorët pranë Qendrës Informative të Arsimit Amerikan i ndihmojnë të interesuarit edhe në formulimin dhe hartimin e Curriculum Vitae, letrës së motivimit, letrave të rekomandimit, etj.

BASHKIMI FAMILJAR

Dy kategoritë e grupeve të Vizave që përfitohen nga Familja, të afërmit e menjëhershëm dhe preferencat familjare, janë dhënë sipas dispozitave të ligjit të migracionit të Shteteve të Bashkuara. Për të aplikuar për një vizë imigrimi për një të afërm të menjëhershëm ose preference familjare, kandidatët duhet të ndjekin hapat në faqen në usvisa.gov. "Pasi të keni përfunduar këto hapa,



Ambasada amerikane

STUDIUMET

Së pari, të interesuarit duhet të shqyrtojnë alternativën më të mirë për arsimim e më tej të përfundojnë dokumentacionin për aplikim. Pas kësaj aplikantët duhet të financojnë studimet duke aplikuar për bursë e më tej duke aplikuar për vizë studentit.

shqyrtoni udhëzimet e dhëna nga Qendra Kombëtare e Vizave (NVC), së bashku me informacionin e paraqitur në këtë faqe, për udhëzime të mëtejshme". - theksojnë ekspertët e ambasadës. Vizat Imigruese bazuar në familjarë të drejtpërdrejtë bazohen në një lidhje të ngushtë familjare me një qytetar amerikan, që përcaktohen si i afërm i drejtpërdrejtë (Immediate Relative - IR). Numri i imigrantëve në këto kategori nuk kufizohet për secilin vit fiskal. Llojet e vizave bazuar në të afërmit të menjëhershëm përfshijnë: IR-1: Bashkëshort/e e qytetarit amerikan;

IR-2: Fëmijë nën moshën 21 vjeç i qytetarit amerikan; IR-3: jetim i birësuar jashtë SHBA nga një qytetar amerikan; IR-4: Jetim që do të birësohet në SHBA nga një qytetar amerikan; IR-5: Prind i një qytetari amerikan, i cili është të paktën 21 vjeç. Ndërkohë vizat imigruese bazuar në preferencën familjare (të Limituarit) janë për lidhjet familjare më specifike, më të largëta, me një qytetar amerikan dhe disa lidhje të përcaktuara me banorin e përherëshëm të ligjshëm (LPR). Për imigrantët me preferencë

familjare ekzistojnë kufizime numerike për çdo vit fiskal, të cilët tregohen në fund të çdo kategorie. Ndërkohë kategoritë e vizave imigruese bazuar në preferencën familjare janë: Preferenca e parë familjare (F1): djemtë dhe vajzat e pamartuar të qytetarëve amerikanë dhe fëmijët e

Vizat imigruese bazuar në familjarë të drejtpërdrejtë:
IR-1: Bashkëshort/e e qytetarit amerikan;
IR-2: Fëmijë nën moshën 21 vjeç i qytetarit amerikan;
IR-3: Jetim i birësuar jashtë SHBA nga një qytetar amerikan;
IR-4: Jetim që do të birësohet në SHBA nga një qytetar amerikan;
IR-5: Prind i një qytetari amerikan, i cili është të paktën 21 vjeç.
Vizat imigruese bazuar në preferencën

familjare (Të Limituarit):
-Preferenca e Parë Familjare (F1): Djemtë dhe vajzat e pamartuar të qytetarëve amerikanë dhe fëmijët e tyre, nëqoftëse kanë;
-Preferenca e dytë familjare (F2): Bashkëshortët/et, fëmijët minoronë, dhe djemtë dhe vajzat e pamartuar (mbi 21 vjeç) të banorëve të përherëshëm të ligjshëm.
-Të paktën 27 përqind e të gjithë vizave të kësaj kategorie janë për bashkëshortët/et dhe fëmijët; pjesa e mbetur u

kalohet djemve dhe vajzave të pamartuar;
-Preferenca e tretë familjare (F3): Djemtë dhe vajzat e martuar të qytetarëve amerikanë, si dhe bashkëshortët/et dhe fëmijët e tyre;
-Preferenca e katërt familjare (F4): Vëllezërit dhe motrat e qytetarëve amerikanë dhe bashkëshortët/et dhe fëmijët e tyre, kur qytetarët amerikanë janë të paktën 21 vjeç.

KATEGORITË E VIZAVE IMIGRUESE

TË PËRJASHTUARIT

Ekspertët e ambasadës theksojnë se gjyshërit, tezet dhe hallat, dajat dhe xhaxhallarët, vjehrrit dhe vjehrra, dhe kushërinjtë nuk mund të bëjnë bashkim familjar. Preferenca e katërt familjare (F4) përfshin vëllezërit dhe motrat e qytetarëve amerikanë dhe bashkëshortët/et dhe fëmijët e tyre, kur qytetarët amerikanë janë të paktën 21 vjeç.

tyre, në qoftë se kanë; Preferenca e dytë familjare (F2): Bashkëshortët/et, fëmijët minoronë, dhe djemtë dhe vajzat e pamartuar (mbi 21 vjeç) të banorëve të përherëshëm të ligjshëm. Të paktën 27 përqind e të gjithë vizave të kësaj kategorie janë për bashkëshortët/et dhe fëmijët; pjesa e mbetur

u kalohet djemve dhe vajzave të pamartuar. Preferenca e tretë familjare (F3) përfshin djemtë dhe vajzat e martuar të qytetarëve amerikanë, si dhe bashkëshortët/et dhe fëmijët e tyre. Sakaq, preferenca e katërt familjare (F4) përfshin vëllezërit dhe motrat e qytetarëve ameri-

kanë dhe bashkëshortët/et dhe fëmijët e tyre, kur qytetarët amerikanë janë të paktën 21 vjeç. Ekspertët e ambasadës theksojnë se gjyshërit, tezet dhe hallat, dajat dhe xhaxhallarët, vjehrrit dhe vjehrra, dhe kushërinjtë nuk mund të bëjnë bashkim familjar.

TË RINJTË E FORUMEVE POLITIKE DHUROJNË GJAK, META VLERËSON AKTIN

Ditën e djeshme forumet rinore të FRESH, FRPD dhe LRI u bashkuar "Aleancës për Dhurimin e Gjakut". Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta vlerësoi të rinjtë që u bashkuar një kauze të tillë. "Falënderoj me zemër forumet rinore të FRESH, FRPD dhe LRI që i janë bashkuar "Aleancës për Dhurimin e Gjakut", duke treguar një ndjenjë të lartë përgjegjshmërie sociale, solidariteti dhe humanizmi. Është e rëndësishme që së bashku të ndërmarrim një fushatë ndërgjegjësimit të të gjithë të rinjtë për suksesin e kësaj kauze jashtëzakonisht humane", -u shpreh Meta.



FOTOLAJM

Përlëshja mes palëve para Gjykatës së Apelit Vlorë

Sherri për rrugën e gurores, biznesmeni Ylli Salla nga Elbasani përplaset fizikisht me ish-ortakun

VLORE - Një seancë në Gjykatën e Apelit të Vlorës ka përfunduar dje në sherr masiv jashtë ambienteve të këtij institucioni. Pas konfrontimit fizik për motive pronësie mes palëve në proces, janë plagosur tre persona, ndërsa tre të tjerë janë shoqëruar nga policia. Mësohet se konflikti ka nisur për rrugën që të dërgon në një gurore në fshatin Lepenicë të bashkisë së Selenicës. Fillimisht gurorja ka qenë në bashkëpronësi të biznesmenit Ylli Salla nga Elbasani dhe Vendim Durmishaj, banor i zonës së Lepenicës. Durmishaj pretendon se ish-ortaku i tij, Salla ia mori padrejtësisht guroren me vendime të dyshimta në gjykata, ndaj

KONFLIKTI

Vendim Durmishaj nga Lepenica pretendon se ish-ortaku i tij, Ylli Salla ia mori padrejtësisht guroren me vendime të dyshimta në gjykata, ndaj dhe i bllokoji rrugën. Ai pohon se Salla nuk ka paguar shpenzimet për ndërtimin e rrugës, prandaj nuk e ka lejuar që të kalonte aty. Pas konfliktit mes tyre, çështja ka përfunduar në gjykatë.

dhe i bllokoji rrugën. Ai pohon se Ylli Salla nuk ka paguar shpenzimet për ndërtimin e rrugës, prandaj nuk e ka lejuar që të kalonte aty. Pas konfliktit mes tyre, çështja përfundoi në

gjykatë. E ndërsa, dje Apeli dha vendimin në favor të biznesmenit Ylli Salla nisi debati mes dy familjeve brenda ambienteve të gjykatës. Më pas, konflikti vazhdoi edhe jashtë saj me përplasje fizike

dhe goditje me sende të forta. Për pasojë mbeti i dëmtuar një 53-vjeçar, me banim në Peqin, biznesmeni Salla si dhe Vendim Durmishaj me të birin. Me mbërritjen e policisë tre autorët e dyshuar të ngjarjes u shoqëruan në komisariat. Biznesmeni Ylli Salla që fitoi gjyqin, akuzon palën tjetër se i zunë pritë dhe e goditën me mjete të forta në kokë. Më kishin zënë pritë, nuk është hera e parë. Më goditën me doreza. Ai thotë se për shkak të këtij konflikti firma ka pezulluar aktivitetin prej dy vitesh"-u



Biznesmeni Ylli Salla

shpreh Salla. Nga ana tjetër, bashkëshortja e Vendim Durmishaj pretendon të kundërtën. "Bashkëshorti hapi një gurore dhe mori si ortak Ylli Sallën nga Elbasani. Pasi bëri dokumentet, ortaku i hoqi emrin burrit tim dhe e mori mbi vete guroren. Rrugën për te gurorja e ka bërë im shoq,

ndërsa ka kontribuar dhe një firmë tjetër, ndaj ne kërkojmë që ai të na japë paratë dhe pastaj të kalojë. Në momentin që u futën në gjykatë, dikush provokoi aty dhe pati një konflikt dhe debatuan. Ylli Salla lajmëroi policinë. Erdhi policia dhe arrestuan disa vetë", u shpreh Alma Durmishaj.

Donjet Beqiraj: Ka kaluar çdo afat ligjor. Prokuroria të zbardhë ngjarjen

E vrau shoku me çekiç në kokë dhe e groposi, vëllai i viktimës: Shpresojmë të jetë gjallë

FIER

Po bëhen afro 5 muaj nga gjetja e disa eshtrave në fshatin Daullas të Fierit. Në atë kohë policia dhe prokuroria deklaruan se eshtrat i përkasin vëllait tim, Kreshnikut. Ekspertiza mjeko-ligjore konfirmoi se eshtrat janë të një mashkulli. Ndërkohë, ne jemi krejt të paqartë në lidhje me ngjarjen, pasi ende nuk është gjetur koka dhe nuk ka dalë analiza e AND-së. Ka kaluar çdo afat ligjor, dhe nuk e dimë nëse vëllai im është gjallë apo është vrarë nga personi i arrestuar, Albert Zekaj". Kështu deklaroi dje Donjet Beqiraj, vëllai i 36-vjeçarit Kreshnik Beqiraj që u masakrua qershorin e vitit të kaluar nga shoku i tij, Albert Zekaj. Ndërkaq, Donjet Beqiraj u bënë apel strukturave të drejtësisë që të hetojnë lidhur me ngjarjen dhe ta zbardhin atë. Ai pohoi se ndonëse se Albert Zekaj nga fshati Kalldrun i Malësisë së Madhe pranoi autorësinë e krimit dhe tregoi vendin ku ndodhej trupi i pajetë i Kreshnikut, vëllai i tij zyrtarisht rezultoi i zhdukur dhe jo i vrarë. "Deri tani ne disponojmë vetëm të dhënat e deklaruara nga prokuroria e Fierit, ndërsa ende nuk kemi marrë përgjigje zyrtare që vëllai im ka vdekur. Unë kërkoj që të zbardhet ngjarja, të bëhet drejtësi. Duhet të na japë përgjigje shteti. Si dhe fakte konkrete që vëllai im, Kreshnik Beqiraj ka vdekur. Nëse është ai, duhet të na thuhet zyrtarisht, që ta përcjellim për në banesën e fundit. Ne si familje kemi shpresa se ai mund të jetë gjallë", tha Donjet Beqiraj. Ndërkohë, burime pranë organit të akuzës bënë me dije për "Gazeta Shqiptare" se është kryer ekspertiza mjeko-ligjore prej nga është

"Kreshniku rezulton të jetë i zhdukur. 5 muaj pas gjetjes së eshtrave ende s'ka dalë analiza e AND-së"



Vëllai i viktimës, Donjet Beqiraj



Viktima Kreshnik Beqiraj



Vendi ku u gjetën eshtrat

konkluduar se trupi i gjetur është i seksit mashkull dhe i moshës së Kreshnikut, ndërkohë që koka e tij nuk u gjet në vendin e ngjarjes. Ndërkaq, pritet ende një përgjigje nga autoritetet gjermane për analizën e AND-së. "Ne përdërisa nuk

kemi fakte zyrtare që im vëllai, Kreshniku ka vdekur, mendojmë se është gjallë", u shpreh Beqiraj.

NGJARJA

Më 8 mars të këtij viti, policia dhe prokuroria e Fierit arritën të zbardhnin vrasjen e 36-vjeçarit Kresh-

VRASJA NË 2017

Më 8 mars të këtij viti, një trup i pajetë u gjet i groposur në fshatin Daullas të Fierit. Në lidhje me këtë ngjarje u arrestua 32-vjeçari Albert Zekaj nga Malësia e Madhe, i cili gjatë marrjes në pyetje tha: "Unë jetoja në një shtëpi me qira me Beqirajn. Ne kishim probleme me pagesën e qirasë që prej një viti. I kërkova lekët, por ai më tha se nuk kam. Atë natë që ndodhi ngjarja kam qenë i dehur. Kreshnikun e godita disa herë me çekiç në trup".

nik Beqiraj, banues në këtë qytet si edhe të zbulojnë autorin e kësaj ngjarjeje makabre, Albert Zekajn nga Malësia e Madhe. Pas disa muaj hetimesh, Zekaj pranoi krimin dhe rrëfeu para hetuesve se mbrëmjen e 22 qershorit të vitit të kaluar, kur ishte kthyer në shtëpi e kishte qëlluar me çekiç në kokë Kreshnikun. Ndërsa dy ditë më pas e ka copëtuar dhe e ka hedhur në një kanal në fshatin Daullas të

Bashkisë Fier. Por, pavarësisht se ka pranuar autorësinë dhe ka treguar vendin ku kishte hedhur trupin e të ndjerit, Albert Zekaj nuk ka treguar ende motivin përse e vrau shokun e tij, i cili e kishte strehuar për dy vite në një banesë të marrë me qira në qytetin e Fierit. Në atë kohë u tha se Zekaj ishte shok me viktimën Kreshnik Beqirajn dhe se ish-injohur tre vite më parë në një burg në Belgjikë.

Sekuestrohen 60.8 kg kanabis, përfundon në pranga 44-vjeçari SARANDË - Policia e Sarandës ka sekuestruar një sasi prej 60.8 kg kanabis, ndërsa ka arrestuar në flagrancë poseduesin. Mësohet se gjatë operacionit të koduar "Street", blutë e qytetit bregdetar kanë vënë në pranga shtetasin Arben Nguli nga Librazhdi, banues në Sarandë. Sipas policisë, 44-vjeçari u vu në pranga, pasi në vendin e quajtur "Qafa e hantit" në fshatin Shkallë, u kap duke udhëtuar me mjetin tip "KIA", në të cilin po transportonte 60.8 kg drogë drejt Greqisë. Po të njëjtat burime bënë me dije se Arben Nguli kishte me vete edhe 2 ukrainase për kamuflim. Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua lënda narkotike dhe automjeti. Materialet hetimore u referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për veprën penale "Prodhim, shitje narkotikësh".

SUPER VERË, SUPER SMARTPHONE!

SUPER ÇMIM
20,500 LEKË

3GB
10 MINUTA
NDËRKOMBËTARE



Versioni më i fundit i Android

Ekran 5.7 inch

13 MP kamera Selfie/kryesore

3 GB RAM

32 GB memorie e brendshme
(që zgjerohet deri në 128 GB)

Merr smartphone-in më të fundit General Mobile 8 me 3GB internet brenda muajit kalendarik, si edhe 10 minuta ndërkombëtare për 30 ditë, dhuratë për rimbushje nga 1,000 Lekë.

 www.albtelecom.al  /albtelecom.al  123

 **ALBtelecom**
...me ju të parët!

NUTRICIONISTËT BIEN DAKORD QË VAJI I ULLIRIT ËSHTË MBRETI I VAJRAVE.

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E premte 27 Korrik 2018



Francë, kryebashkiaku "ndalon" hyrjen e mushkonjave në qytezë



Vaji i ullirit, mbreti i vajrave

BULEVARDI POLITIK



- Trondit Nard Ndoka me deklaratën: Në parlament ka homoseksualë dhe përdhunues
- S'përbahet deputeti i PD ndaj Ramës e Veliajt, Paloka shan keq: Kemi dy k..va në shtëpi
- Francë, kryebashkiaku "ndalon" hyrjen e mushkonjave në qytezë
- Biseda e një deputeti me granan



Rrëfehet kryebashkiakja: Një nënë e rreptë nxjerr fëmijë shembullorë

MAJLINDA BUFI:
**Nuk jam njeri i zyrave
dhe i komoditetit**

"Puna është pasioni im"

Rrëfhet kryebashkiakja: Një nënë e rreptë nxjerr fëmijë shembullorë

Majlinda Bufi:

Nuk jam njeri i zyrave dhe i komoditetit

"Puna është pasioni im"

Egla Xhemali

Qyteti i Roskovecit është duke festuar anekënd 95-vjetorin e krijimit të qendrës administrative këto ditë. Ngjyrat harmonizohen këndshëm me emocionet e banorëve të kësaj qyteze të vogël dhe me organizimet e aktiviteteve që po mundëson bashkia. Në këtë atmosferë të ngrohtë kryetarja e bashkisë zonja Majlinda Bufi na mikëpret dhe rrëfhet për suplementin e "Gazeta Shqiptare", "Summer Pages" për lidhjen e fortë që ka me qytetin, për rrugëtimin përgjatë viteve në vendimmarrje në të gjithë vepërimitaritet e saj, për familjen pasionet dhe objektivat që ka për të ardhmen. Kryetarja na tregon se si fillimisht nuk donte të bëhej inxhinierë, për pasionin që ka për punën dhe librat, udhëtimet si dhe për nënën që mundohet të kombinojë tolerancën dhe rreptësinë në qëndrimin ndaj fëmijëve. Majlinda Bufi na flet për vlerat e çmuara që kanë gjurmët e lëna ndër vite, për kulturën në Roskovec dhe si gjithë ky konglomerat i përket asaj që e duam më së shumti dhe që na identifikon, identitetit. Natyra e saj e bën që të jetë e pandashme me punën ndaj kjo ka ndikuar dhe në përzemërsinë që krijon kushdo kur komunikon me kryetaren e bashkisë së Roskovecit. Majlinda pohon se do të donte të kishte dhe një mandat të dytë për të përbushur tamam objektivat që do t'i shohë doemos të realizuara goftë dhe si qytetare e thjeshtë. Ajo ndihet mjaft optimiste për gratë dhe vajzat që i janë futur politikës dhe kanë të drejtë vendimmarrjeje, po na thekson, gjithashtu, se çdo lloj suksesi arrihet nëpërmjet dëshirës për të punuar. E pyetur nëse do të donte që fëmijët e saj t'i hynin politikës Majlinda thotë se ka dëshirë që ata të bëhen njerëz të mirë dhe profesionist në të njëjtën kohë e nëse komuniteti do i dojë, do jenë këta të fundit që do e përcaktojnë zgjedhjen e tyre.

Ju jeni inxhinierë në profesion, çfarë ju shtyu që të hynit në politikë?
Unë jam inxhinierë ekonomike.

Në 1995 kam mbaruar Fakultetin e Inxhinierisë së ndërtimit. Në vitin 2000 kam mbaruar me korrespondencë Fakultetin Ekonomik përpos trajnimeve e studimeve të tjera, që kam bërë më pas, por çdo inxhinier dhe çdo ekonomist, së pari, është njeri, familjar, është pjesë e komunitetit dhe shoqërisë ku ai jeton dhe unë jam shumë e bindur që inxhinierë apo ekonomist apo çfarëdoqoftë është një profesion brenda çdo profesionisti që ka një karakter, ka një identitet ka një shpirt të veçantë sigurisht, sepse të veçantat përbëjnë të tërën dhe ky njeri është pjesë e kësaj shoqërie dhe ka, le të themi, sfidat e veta përtej profesionit, brenda njeriut përtej profesionit.

Sa e vështirë është të jesh drejtuese bashkie?

Kryetar bashkie sot është e vështirë, se nuk ka më komuna, pra pas 2015 është e vështirë në kuptimin e komunikimit dhe përbaljes me njerëzit, por është shumë e bukur në kuptimin e realizimit të objektivave, e realizimit të sfidave e marrjes së fitbekut të drejtpërdrejtë në momentin që ti ke realizuar këto objektiva në momentin për shembull që ti ke prezantuar alternativat e programit tënd kur ke marrë detyrën. Unë për shembull kam pasur një program real dhe konkret, po përmend vetëm një objektiv në fund të 4-vjeçarit komunikimin nga qendra e çdo fshati me qendrën e bashkisë me rrugë të asfaltur. Sot, le të themi, kur ka filluar viti i katërt i mandatit më ka mbetur vetëm një fshat. Dua shumë që në qershorin e vitit që vjen ta kem përbushur dhe këtë objektiv të rëndësishëm, sepse nuk ka kënaqësi më të madhe për njeriun kur shikon të përbushur këtë lloj objektiv.

Ç'mendim keni për përfshirjen e grave në vendimmarrje dhe në politikë?

Në fakt, çështjet gender janë shumë të ndjeshme jo vetëm në Shqipëri, po pothuajse në çdo shtet të botës, sepse është thënë



shpesh, thuhet gjithmonë që gratë janë gjysma e shoqërisë, po të kalojmë në shifra kalojnë dhe 50%, por gruaja është pjesë e jetës në familje, është pjesë e jetës dhe në transmetimin e jetës. Çështjet gender janë sot çështje reale dhe të diskutuara dhe po t'u futemi statistikave ka më shumë se 51% gra dhe vajza në të gjithë botën. Le të themi, që kur vendimet janë pjesë të procesit të vendimmarrjes, është vërtetuar që vendimet janë më të ndjeshme, më reale më frytdhënëse kur merren nga gratë. Shpeshherë ka ndodhur kur kam qenë anëtare e këshillit në bashki, shumë herë më përpara në momentet që futesha unë në diskutim, kam qenë e vetmja grua në këshillin e bashkisë

në atë kohë, sigurisht që eliminoreshin sharjet, fyerjet, zbuteshin tonet. Fillohej që të mendohej për vendimin që do merrej dhe në këndvështrimin gjinor. Pra, vetëm nisur nga ky element unë e them me bindje që përfshirja e grave në vendimmarrje është shumë e rëndësishme. Unë kam qenë pjesë e procesit në atë kohë, në vitin 2008, dhe e rregullimit të ligjit për çështjet gjinore, pikërisht të pjesëmarrjes 30% të grave në listat zgjedhore në parlament. Sot për këshillat vendore 50% e listës duhet të jetë e seksit të kundërt. Të gjitha këto kanë bërë që të rritet numri i grave dhe i vajzave në këshillat bashkiakë dhe po ashtu në parlament ne kemi një numër të konsiderueshëm, po të përmendim

dim këtu dhe që në qeveri ka 50% gra dhe vajza ministrë. Ajo që sot kërkohet në Shqipëri është cilësia që do të thotë ne nuk duhet të plotësojmë listat me gra dhe vajza thjesht për të vënë një emër ndryshe në listë, por duhet të fusim këto gra dhe vajza që realisht i japin kuptim qenies aty brenda.

Në Roskovec është një komunitet rom. Si i trajton? A ka diferencime apo nuk ndodh kjo?

Në Roskovec ka një komunitet rom rreth 300-350 individë. Janë në përgjithësi të integruar, që do të thotë nuk është kategoria lëvizëse ose emigruese e romëve. Janë të stabilizuar me shtëpi, me familje. Ne në bashki kemi një politikë mbështetje për romët, jemi pjesë e një projekti mjaft të rëndësishëm që këshilli i Evropës po zbaton, në rajon dhe në Shqipëri. Janë, le të themi, shtatë bashki në Shqipëri dhe në shtatë vende të rajonit, pra gjithsej 49 vende në të cilat janë evidentuar prani të komunitetit rom dhe bashkia e Roskovecit është një prej tyre. Ne kemi bërë të mundur një përfaqësues nga komuniteti rom që është pjesë e qendrës komunitare në Roskovec, i cili punon vetëm për këtë gjë. Kemi hartuar lista të sakta për ta, sa familje rome kemi, sa fëmijë, sa gra, sa kemi të punësuar, sa prej tyre merren me biznes. Gjashhtë prej tyre janë pjesë e punonjëseve dhe janë pjesë e shërbimeve në bashkinë e Roskovecit. Ne prej gati dy vitesh të kaluara kemi përfutur nga ministria për zhvillimin urban projektin për përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit romë që do të thotë se çdo vit janë rehabilituar nga 30-38 shtëpi të komunitetit rom, pra janë përmirësuar çati, dyer, dritare, banjo, sipas nevojave kushtet e banimit për komunitetin rom. Tani ne →



← në bashkëpunim me këtë projektin që përmenda nga "Këshilli i Evropës" do të hartojmë kartën e mbështetjes sociale për kategoritë në nevojë dhe për komunitete të ndryshme pjesë e të cilës është dhe komuniteti rom në Roskovec. Po ju them dhe diçka tjetër, në një garë që u zhvillua me mbështetjen e këshillit të Evropës dhe donatorit të ndryshëm në Shqipëri në qoftë se Tirana mori vendin e parë, Roskoveci mori vendin e dytë.

Jeni mjaft e angazhuar me problemet e artit dhe të kulturës. Ky është një pasion apo peng juaj?

Unë jam e bindur që historinë e një vendi apo të një komuniteti e bëjnë gjurmët e lëna. Sa më shumë gjurmë të gjenden aq më mirë historia është e dukshme, e qartë. Shqipëria në 500 vite pushtim otoman kishte humbur pothuajse identitetin e vet dhe pikërisht për shkak të kësaj gjëje. Roskoveci është krijuar si njësi administrative në vitin 1923 me ndarje e parë territoriale, por ka ekzistuar shumë shpejt me emërtimin "Pazari i Frashërit". "Pazari i Roskovecit" dhe ky lloj emërtimi kishte brenda të mirat dhe të këqijat e veta, por ama tregon identitet, tregon bashkësi tregon moshë. Askush më përpara nuk e kapi këtë gjë nga ky këndvështrim për të thënë dhe për të lënë gjurmë konkrete që, ky vend ku ne jetojmë, është i lashtë. Unë jam përpjekur që në vitin e parë ta përçoj përmes televizionit, emisioneve të ndryshme historinë e Roskovecit. Këtu ka kaluar një pjesë e rrugës Egnatia,

Roskoveci ka qenë stacion ku ndaleshin udhëtarë të ndryshëm, që tregon përsëri gjurmë shumë të lashta dhe kjo kthehet sot përmes shkrimeve, përmes këngëve, përmes fabulave, përmes gojëdhënave. Në qoftë se të gjitha këto nuk bëhen të dukshme për të këtë brez, për të rinjtë atëherë si do t'ua transmetojmë të tjerëve? Prandaj ndoshta dhe ky pasioni im i brendshëm për të lexuar dhe për të hapur çdo lloj dritare të brendshme, ka bërë që unë të jem këmbëngulëse në këtë drejtim. Nuk është e thënë që një vend të ketë vetëm rrugë. Sigurisht që rruga është e nevojshme, shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm është i domosdoshëm, ndriçimi është i nevojshëm se pa to nuk ka jetë, por përtej kësaj këto tregojnë identitetin tonë.

Ju keni qenë deputete, cila është arsyeja që ju "shkëputi" nga parlamenti?

Ju m'u drejtuar mua në fillim me profesionin inxhinierë. Unë jam inxhinierë në profesion, inxhinierë ndërtimi dhe që nga momenti i parë e kam parë gjithmonë veten në terren. Nuk jam njeri i zyrave, njeri i komoditetit edhe pse komoditeti dhe zyra është pjesë e jetës e çdo profesionisti që në fund të ditës duhet të bëjë bilancin e gjërave. Padyshim, nëse nuk bëjmë një bilanc ditor, diçka harrohet. Kjo ka lidhje dhe me profesionin tim, ka lidhje ndoshta dhe me faktin se unë kam qenë e përfshirë me politikën lokale më herët e duke qenë e përfshirë me politikën lokale i kam njohur shumë mirë pro-

blemet që ka Roskoveci dhe në 2013 rasti e sollë që unë u bëra anëtare e parlamentit e ndjenja atje vetëm dy vjet, që më bëri mua që ta njoh shumë mirë si funksionon ky institucion nga brenda për të kuptuar që deputet është një detyrë shumë komode dhe kryetarë bashkie është detyrë shumë e rëndësishme dhe e vështirë.

Si e ndani kohën mes punës dhe familjes?

Familja ime përbëhet nga bashkëshorti dhe nga dy fëmijët e mi, Iva dhe Marvi. Iva është 16, Marvi është 15. Janë në një moshë që ka shumë kërkesa, le të themi, që duan më shumë kohë për kënaqësitë e tyre. Jam përpjekur që të ndaj pjesën e punës nga pjesa e familjes, mos t'i përziejnë njerë me tjetrën, por që nuk mundet është e vështirë sepse fakti që këtu është një komunitet i vogël, njerëzit njihen shumë mirë njëri me tjetrin, të dinë shtëpinë ku jeton dhe se kanë problem të vijnë të trokasin në dera në çdo moment. Në momentin që dikush vjen duke qarë të dera, kam sjellë në mënyrë të menjëhershme një problem të tyre, që është bërë pastaj e familjes, kështu që jo gjithmonë ngelet kohë për ta shijuar. Le të themi, në mënyrë absolutisht të ndarë mes punës dhe familjes, por që përpjekim që edhe fëmijëve edhe bashkëshortit, po dhe vetes sime t'i jap kohën e duhur se në fund të fundit unë jam njeri si të gjithë të tjerët. Jam në këtë detyrë sot, dua që ta bëj mirë këtë detyrë sa kohë që e kam, por në fund të fundit jam njeri. Nesër do kthehem përsëri në

jetën time të përditshme e di shumë mirë këtë gjë pasi këtu jam e përkohshme. Asnjëri nuk ka lindur kryetar, deputet apo çfarëdo qoftë, por e rëndësishme është që në kohën që është në detyrë, çfarë gjurmësh lë, çfarë bën ai për veten e vet, për komunitetin, për të gjithë ata njerëz që e kanë votuar dhe kanë besuar tek ai.

Meqë jemi te kujdesi juaj për fëmijët, jeni nënë tolerante apo e rreptë?

Përpjekim të kombinoj rreptësinë aty ku duhet dhe tolerancën atëherë kur ajo nuk prish punë më shumë se ç'duhet. Thotë një fjalë që "Një nënë e rreptë nxjerrë fëmijë shembullor". Shpesh e dëgjoj këtë gjë, e unë jam në përgjithësi pak natyrë e rreptë përpjekim që ta kombinoj dhe ta kem rreptësinë aty ku duhet rreptësia për të parë që një tekë apo një kërkesë e tejkalon një çikë atë masën të fëmijët, por në përgjithësi përpjekim të jem e kombinuar.

A do të donit që fëmijët tuaj të bëhen pjesë e politikës në të ardhmen?

Së pari, unë do të doja që ky të ishte një vendim që do të vinte normalisht të fëmijët e mi, të jetë një rrjedhje normale e jetës. Unë në radhë të parë dua që ata të bëhen njerëz, profesionistë të mirë dhe pastaj, nëse ata do jenë njerëzit e duhur për t'i dhënë komunitetit jam shumë e bindur që do të jetë, vetë komuniteti që do të përcaktojë. Shoqëria është në evolucion e sipër është në zhvillim, njerëzit ndërgjegjësohen dhe sa më shumë kohë kalon unë besoj që politika do jetë më reale edhe pas disa proceseve që janë duke ndodhur apo do të ndodhin në Shqipëri. Këto procese do shoqërohen me ndryshimin e mentalitetit kështu që jam shumë e bindur që komuniteti dhe shoqëria do zgjedh ata politikanë që duhet dhe jo ata lloj njerëzish që i vënë vetes synim për t'u bërë politikanë ose që i futen politikës për biznes.

Nëse do ktheheshit pas në kohë, çfarë gjëje do e kishit bërë ndryshe?

Nuk besoj që do kisha bërë gjëra ndryshe, sepse, në fakt, deri këtu nuk është se kam bërë gjëra me imponim, gjërat kanë ardhur të tilla, por po të ma kishin lënë në dorë, mbase zgjedhjen e profesionit. Kur kam mbaruar gjimnazin, kam dalë me rezultate shumë të mira, por atëherë nuk kishe mundësi zgjedhje, do veje në fakultet ku ta përcaktonte këshilli popullor i lagjes të drejtën e studimit. Nuk kam dashur të bëhesha inxhinierë, kam qenë e dhënë pas gjuhëve të huaja në atë kohë dhe ndoshta këtu do kisha bërë zgjedhje tjetër, por pjesën tjetër të jetës besoj do isha kështu ku jam pasi kjo ka lidhje me natyrën time dhe karakterin tim.

Cilat janë pasionet tuaja më të mëdha?

Nuk është se kam ndonjë pasion shumë të veçantë. Në përgjithësi punën e kam pasion do të thotë që kudo që jam unë punoj me shumë pasion. Edhe kur kam qenë pjesë e biznesit, jo kaq shumë e përfshirë në politikë, atë që dua ta bëj mirë dua ta bëj mirë deri në fund edhe jam shumë këmbëngulëse nga natyra

që do të thotë nëse i vë vetes një objektiv dua ta arrij patjetër dhe përpjekim të lexoj. Leximin asnjëherë nuk e heq nga vetja. Shumë jam te librat e printuar jo tek elektronikët. Këto janë më së shumti, pasionet e mia, por edhe ndjenja me familjen dhe udhëtimi.

Si fillon një ditë e zakonshme për ju?

E filloj ditën pak herët dhe nganjëherë më vjen zor nga punonjësit kur vij ndonjëherë më shpejt se ata në 7:30 në punë. Dua që gjërat t'i shoh vetë me sy, nuk kam besim shumë të të tjerët. Dal bëj ndonjë kontroll çfarë është bërë, çfarë ka ndodhur, si është situata. Është një ditë e zakonshme pune me kontroll, me lënie detyrash, me raportime.

Gjithashtu, pjesë e delegacionit shqiptar në Strasburg. Shqipëria ka një delegacion në Këshillin e Evropës që përfaqëson pushtetin vendor. Ne jemi katër veta nga Shqipëria. Unë jam nënkryetare e delegacionit, kryetar është Erion Veliaj. Shpesh për shkak të ngarkesave Erioni është i zënë dhe mua më duhet që ta ndjek këtë axhendë. Kjo më ka bërë që të jem edhe pjesë e komisioneve, monitorimeve në vende të ndryshme të botës, më ka bërë që të udhëtoj, po nuk më pengon kjo për punën që kam.

Zonja Majlinda, a i keni planifikuar? Ku do t'i kaloni?

Deri më tani nuk është se kam bërë pushime. Mund të bëj ndonjë pushim nga fundi i gushtit me familjen, pak ditë sepse dhe familja ka nevojë për të qenë e gjithë se bashku. Nuk më pëlqen shumë deti, shkoj për fëmijët atje. Mua më pëlqen pylli, lëvizja ajri i pastër, por gjithsesi të kombinuaru them që patjetër që do bëjmë pushime se janë pjesë e jetës.

Cilat janë objektivat tuaja për të ardhmen?

Unë kam edhe një vit nga ky mandat. Padyshim që dua që këto punë që kemi nisur tani t'i mbarojmë brenda afatit. Nuk dua ta mohoj apo të jem hipokrite të them që nuk dua të kem një mandat tjetër ku ta vazhdoj detyrën time edhe për një katër vjeçar, nëse sigurisht partia ime do të më nominojë si kandidatë dhe pastaj nëse dhe qytetarët do të më votojnë, sepse janë dy sfida përballë meje, por do të doja ta vazhdoja këtë detyrë për të përmbytur dhe disa objektiva që unë nuk kam arritur t'i përmbytur. Për shembull po të shikosh në qytet unë nuk kam arritur të bëj projektin e qendrës së qytetit. Në programin e rindëzjes urbane që qeveria shpalli, që më para, çdo qytet ka përfutur nga ky program dhe ka një ndryshim në qendër të bashkisë, ndërsa në Roskovec nuk është bërë kjo gjë, për shkak se ne kemi pasur disa nevoja të tjera, kemi përfunduar unazën, kemi ndërhyrë në periferi me rrugët, me asfaltet, me ndriçimin, po projekti i qendrës ende nuk është realizuar për shkak të 2-3 gjërave që ne duhet t'i rregullojmë. Posta e policisë duhet të zhvendoset, disa shpronësime, disa prishje që janë të ish-depove të vjetra. Ky është një objektiv që unë ende nuk e kam realizuar dhe qoftë si inxhinierë, por edhe si banorë nuk do të doja të ikja nga kjo detyrë pa mbyllur dhe këtë pjesë.

Nutricionistët bien dakord që vaji i ullirit është mbreti i vajrave. Me këtë, sigurisht që mendohet për vajin e ullirit ekstra virgjin, i cili fitohet me filtrimin e ullinjve të shëndoshtë, proces gjatë të cilit, përmbajta e përbërësve të dobishëm mbetet e ruajtur maksimalisht

Eparë nga ana ushqyese, vaji i ullirit ekstra virgjin është ushqim i çmuar, i pasur me klorofil dhe karatenoide, të cilat përveç ngjyrës karakteristike, i sigurojnë edhe veçoritë antioksidante. Aktivitetin antioksidant ia shton edhe vitamina E, e cila në vajin e ullirit gjendet në formën më të shfrytëzueshme. Vaji i ullirit efektin e vet të dobishëm për shëndetin ia detyron edhe profilin të favorshëm të acideve yndyrore që përmban. Pjesën më të madhe e bën acidi i thjeshtë i pangopur oleik, pjesërisht perçjegjës për tretjen e tij të lehtë. Vaji i ullirit përmban edhe acidet e ngopura yndyrore si acidet palmitike dhe stearike, por edhe acidet e çmueshme poli të pangopura: acidin linolik dhe linoleik.

Efekt i dobishëm i vajit të ullirit

Veçoritë shëruese të vajit të ullirit janë të dokumentuara mirë në letërsinë shkencore. Konsumimi i këtij ushqimi të lashtë ofron mbrojtje nga sëmundjet kronike degjeneruese dhe lidhet me reduktimin e rrezikut nga sëmundjet e zembrës, parandalimin e karcinomës dhe forcimin e sistemit të imunitetit. Po ashtu, i atribuohet edhe veçoritë kundër-inflamatore dhe efekti mbrojtës në mukozen e stomakut.

Vaji i ullirit mbron nga sëmundjet kronike degjeneruese

Në shumë vende të botës konsumi i lartë i yndyrave lidhet me zhvillimin e sëmundjeve degjeneruese si arteroskleroza, diabeti, astma, karcinoma e zorrës së trashë dhe artriti. Kjo nuk vlen për zonën e Mesdheut, me gjithë konsumimin e lartë të yndyrave nga banorët e tij. Burimin kryesor të yndyrave në ushqimin mesdhetar e përbën vaji i ullirit, konsumimi i rregullt i të cilit i kontribuon jetëgjatësisë dhe mundësisë më të vogël për t'u sëmurë nga sëmundjet degjeneruese. Në mbështetje të kësaj flet edhe studimi i kryer në revistën "British Journal of Nutrition". Në studim kanë marrë pjesë 5.611 persona më të vjetër se 69 vjeç. Të anketuarit, të cilët kanë ndjekur regjimin mesdhetar të ushqimit, çka ka nënkuptuar konsumimin e lartë të vajit të ullirit, perimet e freskëta, supën dhe mishin e pulës kanë pasur dukshëm rrezik më të vogël nga vdekshmëria.

Vaji i ullirit dhe shëndeti i sistemit kardiovaskular

Për shkak të përmbajtjes së lartë të acidit oleik dhe antioksidantëve të fortë, vaji i ullirit mbron nga i ashtuquajturit kolesterol HDL i mirë, ndërsa redukton përqindjen e kolesterolinës së keqe LDL. Sh-



Vaji i ullirit, mbreti i vajrave



kencëtarët nga departamenti për ushqim dhe vlera ushqyese, Universiteti i Barcelonës kanë matur ndikimin e acidit oleik dhe antioksidantëve në kolesterolin LDL pas konsumimit të papritur dhe afatshkurter të vajit të ullirit ekstra virgjin. Hulumtuesit kanë zbuluar që acidi oleik dhe antioksidantët ruajnë kolesterolin LDL nga oksidimi, duke parandaluar në atë mënyrë mënyrën e zhvillimit të arterosklerozës.

Vaji i ullirit rregullon tensionin

Rezultatet kanë treguar që edhe pse shqimi mesdhetar në tërësi ul tensionin e rritur, meritat për

efektin e favorshëm më së shumti i takojnë vajit të ullirit. Madje, edhe konsumimi i moderuar i vajit të ullirit në mënyrë të suksesshme redukton tensionin e gjakut, tregon hulumtimi i kryer në kohën e fundit në qindra meshkuj të shëndetshëm nga vendet mesdhetare dhe jomeditare. Të anketuarit gjatë ditës kanë konsumuar 25 ml vaj ulliri. Është interesante që rritja e theksuar e nivelit të acidit oleik në gjak dhe reduktimi i tensionit të gjakut ishte më i shprehur te personat e pamësuar me ushqim mesdhetar (gjermanët, danezët dhe finlandezët).

Vaji i ullirit balancon nivelin e sheqerit në gjak

Hulumtimet te diabetikët zbulojnë që shujtat të cilat përmbajnë pak vaj ulliri veprojnë më mirë në nivelin e sheqerit në gjak nga shujtat e shëndetshme me përqindje të ulët të yndyrave. Përveç kësaj, kur shkencëtarët personave me diabet të tipit 2 i kanë dhënë ushqim të pasur me karbohidrate ose ushqimin e pasur me yndyrat e ngopura ose ushqim mesdhetar me shumë vaj ulliri, është përmirësuar ndjeshmëria në insulinë.

Veprimi kundër-inflamator i vajit të ullirit

Konsumimi i rregullt i vajit të ul-

lirit redukton rrezikun e të sëmurit nga astma dhe artriti reumatoid. Hulumtimet shkencore të fundit tregojnë që vaji i freskët ekstra virgjin përmban edhe komponimin kimik oleokantal, i cili vepron si ilaç për lehtësimin dhimbjes. Oleokantal është mjet natyral anti-inflamator, ndërsa ka forcën dhe karakteristikat, të cilat në masë të madhe u përgjigjen ilaçeve popullore kundër dhimbjeve. Konsumi ditor prej 50 gramë vaji ulliri i përgjigjet një të dhjetës së dozës së ilaçeve të rekomanduara kundër dhimbjeve për personat e rritur.

Trondit Nard Ndoka me deklaratën: Në parlament ka homoseksualë dhe përdhunues

I ftuar dje në "KafelIN" në "INTV" ishte deputeti Nard Ndoka. Mes shumë temave politike e jo vetëm, ai sigurisht bëri disa deklaratat nga ato që e kanë bërë të famshëm. I pyetur nga Flavio Qarri rreth përbërjes së Kuvendit, ai pasi e cilësoi si sukses të Bashës pastrimin nga kriminelët, deklaroi se ishin futur përdhunues, pedofilë e homoseksualë. Nga ana tjetër, ai u pyet për pasurinë e tij dhe këmbënguli se edhe në ILDKPI ishte i pastër dhe 900 mijë eurot nuk ekzistonin. Madje, sipas Ndokës, të 3 djemtë e tij ndodhen në Maltë për studime e punë njëkohësisht pikërisht për t'u edukuar edhe me jetën e vërtetë e të ndershme. Para se të vinte Nard Ndoka në studio, Flavio Qarri po ndërvepronte me shikuesit dhe degjuesit e "KafelIN" për shprehjen e tyre të preferuar e kësaj teme nuk mund t'i shpëtonte as deputeti dhe kryetari i PDK, i cili deklaroi se "Mendo Pozitivisht" e frymëzonte çdo ditë. Sigurisht u fol edhe për shprehje që i atribuohen nëpër rrjete sociale e meme, por ai tha që 99% nuk janë të vërteta. Sigurisht, Edi Rama ishte në qendër të kritikave të Ndokës, ndërsa e konsideroi atë një arrogant të dhunshëm.



Spërmbahet deputeti i PD ndaj Ramës e Veliajt, Paloka shan keq: Kemi dy k.va në shtëpi

I papërmbytur deputeti i PD, njëherazi nënkryetari i demokratëve, Edi Paloka ndaj kryeministrit Edi Rama dhe kryebashkiakut Erion Veliaj. Paloka përmes një barsolete s'kursen ofendimet ndaj shefit të qeverisë e kryetarit të bashkisë. "I gjati nuk la investim në infrastrukturë pa bërë. Çdo ditë bën nga një rrugë... në 3D. Velina e 'mamit' çdo ditë merr nga një çmim. Çmimi i fundit ishte 'çmim i parë për furnizimin me ujë', për Tiranën që ka dy orë ujë të pijshëm në ditë. Këta të dy më kujtojnë atë barsoletën ku i biri pyeti të atin për kuptimin e fjalëve 'de jure' dhe 'de facto'... 'De jure - ne duhet të ishim milionerë - i tha i ati. De facto, kemi vetëm dy kurva në shtëpi", shkruan Paloka.



BULEVARDI POLITIK

Në merrni seriozisht! 😊


Francë, kryebashkiaku "ndalon" hyrjen e mushkonjave në qytezë

Andre Marchand, kryetari i Bashkisë Briollay në rajonin aperëndimor francez, Maine-et-Loire, në fillim të muajit ka marrë vendim për "ndalimin e hyrjes së mushkonjave në qytezë", pas ankesave të vazhdueshme të banorëve, pasi vendi është pushtuar nga mushkonjat. Marchand, në deklaratën për shtyp tregoi se Briollay ku jetojnë 3 mijë banorë pas përmbytjeve të muajit qershor është pushtuar nga mushkonjat dhe se banorët janë ankuar nga kjo. Ai tregoi se banorët kanë presion që të gjejnë zgjidhje lidhur me mushkonjat, duke e detyruar të marrë vendim për "ndalimin e hyrjes së mushkonjave në qytezë". "Ky vendim është mënyra humoristike me të cilën mund t'u tregojë njerëzve se nuk mund të bëjë asgjë në lidhje me çështjen", tha Marchand. Ai u shpreh se pavarësisht se janë vendosur kurthe në shumë vende të qytezës, banorët kanë vazhduar të ankohen. Marchand shtoi se pas vendimit, rastësisht është zvogëluar numri i mushkonjave, por në rast të një përmbytjeje të re, numri i tyre mund të shtohet përsëri.



Biseda e një deputeti me gruan

E dashur grua - fillon bisedën deputeti - më thuaj të vërtetën, a më ke tradhtuar ndonjëherë?
Me kokë të ulur, gruaja i thotë:
- Realisht të kam tradhtuar vetëm tri herë, por mos u nxe, se të tria herët e kam bërë vetëm për ty.
- Si vetëm për mua? Më shpjego më mirë - e ngre zërin deputeti.
- Po ja, herën e parë ishte kur të futën në burg. Mu desh të shkoja me gjykatësin që të dha pafajësinë.
- Po më kujtohet - ia kthen deputeti - po mirë, po hera e dytë kur është?
- Po ja, herën e dytë ka qenë kur u bërë drejtor. Për këtë mu desh të shkoja në shtrat me ministrin.
- Po, po më kujtohet ajo kohë, rrudh buzët deputeti. Po hera e tretë?
- Hera e tretë është tani shpejt, kur do të zgjidheshe për deputet. Të kujtohet, t'i luftoj në dhjetë zona, dhe të duheshin 2000 vota...



DEBATI

Ndrenika e Derhemi përballë Pirro Manit e Anagnostit, i kërkojnë Metës teatër të ri

Ende qarkullon në rrjet një fotografi e Robert Ndreni kës e Arben Derhemit përkrah presidentit Ilir Meta. Ajo u shkrep në muajin prill të këtij viti, mbasi këta të dy dhe shumë artistë të tjerë kishin protestuar dhe kërkuar fuqimisht të mos prekej Teatri Kombëtar. Katër muaj më vonë, të njëjtët artistë kryesojnë një listë prej më shumë se 50 artistësh që i kërkojnë Ilir Metës teatër ri.

Çfarë ka ndodhur ndërkohë? Shumë artistë e kanë braktisur kauzën pas takimeve kokë më kokë me kreun e Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj - zyrtari i caktuar nga qeveria për të ndjekur çështjen e teatrit dhe zhvillimin e zonës pranë tij.

Mes atyre që e lanë kauzën duke rënë tanimë dakord për një teatër me Partneritet Publik-Privat janë edhe Ndrenika e Derhemi. Ata që diku i kërkuar Metës të mbron teatrin, tani i kërkojnë ta shembë atë duke dekretuar ligjin e miratuar në parlament më 5 korrik.

PETICIONI

Në një kohë që disa prej artistëve vijojnë të protestojnë kundër shembjes së godinës së dy teatrove kombëtare, një grup artistësh të tjerë i kanë dërguar dje një petition Presidentit të Republikës, Ilir Meta dhe kreerëve më të lartë të shtetit shqiptar, si dhe Delegacionit të Komisionit Europian në Tiranë, ku shprehen pro ndërtimit të një Teatri të ri Kombëtar. Në petitionin e firmosur nga emrat e mëdhenj të skenës shqiptare, kërkojnë që të mos humbet kohë, por të nisë sa më parë ndërtimi i teatrit të ri. Mes emrave që kanë firmosur petitionin janë aktorët Robert Ndrenika, Luftar Paja, Alfred Trebicka, Leka Bungo, Albert Minga, Arben Derhemi, Zamira Kita etj. Mes emrave është edhe Suela Konjari, ish-drejtoresha e Teatrit 'Metropol' në kohën e PD dhe kandidate për këshillin kombëtar të PD, e cila në një intervistë për 'GSH' muaj më parë ishte kundër. Tanimë, ka kaluar kohë.

"Ne aktorët, regjisorët dhe përfaqësuesit e artit skenik shqiptar dëshirojmë t'i u bëjmë me dije dhe të shprehim vullnetin tonë me anë të këtij petitioni të hapur, se jemi për ndërtimin e një Teatri të ri Kombëtar, bashkëkohor dhe modern, ku t'i shërbejë të gjithë komunitetit artistik teatror dhe publikut artdashës. Ritheksojmë se jemi për ndërtimin e një Teatri të ri Kombëtar, modern dhe bashkëkohor, në truallin e tij dhe pa cenuar asnjë centimetër të kësaj prone. Le të mos humbasim me kohë, por t'i japim Tiranës dhe Shqipërisë Teatrin Kombëtar të ardhmës", shkruhet në petition.

REAGIMI I ALEANCËS

Nuk ka qëndruar në heshtje pas lajmit të petitionit, as Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit. Përmasa disa postime në faqen e vet, Aleanca risjell në vëmendje petitionet e firmosura kundër shembjes së teatrove dhe kundër dekretimit të ligjit që i hap rrugë shembjes. Veç petitionit me 134 artistë që kryesohet nga Pirro Mani, Roza Anagnosti e të tjerë. Veç listës së artistëve, Aleanca rikujton listën e arkitektëve që kanë dalë kundër

Luftë petitionesh, ata që ndërruan mendje rrëzojnë kërkesat e veta të dikurshme

04.04.18 Presidenti Meta pret një përfaqësi artistësh të Teatrit Kombëtar

Presidenti i Republikës, Shtet Zbir Meta priti sot, me kënaqësi të tyre, një përfaqësi artistësh të kryesuar nga aktori i mirënjohur Robert Ndrenika.

Ata e njohën Presidentin Meta me shqetësimin e tyre dhe të komunistët të artitëve i shpreh problemet e godinës së Teatrit Kombëtar, që është këtuherë si funksion në një debat publik.

Presidenti Meta, pasi i dëgjoi me vëmendje shqetësimet e tyre, shkoi në rëndësi e dialogut të vazhdueshëm e të transparencës për këtë çështje të rëndësishme, në dobi të rrajes dhe promovimit të vlerave e trashigimit të historisë, kulturore e kombëtare.



shembjes dhe atë të intelektualëve, me shënimin e mëposhtëm: "Gëlltit diku një lugë çorbë të prishur dhe vjell tërë jetën" thotë një batutë e famshme nga një film shqiptar. E

pra sot, më shumë se kurrë, shqiptarët duhet ta dinë se shumica e artistëve nuk e ka 'ngrenë atë lugë çorbë', kështu që nuk do të 'vjellë' kurrë. Janë 134 artistë që i



Aleanca për Mbrojtjen: Ha një lugë çorbë të prishur e vjell tërë jetën

kanë thënë publikisht PO ndërtimit të teatrit të ri dhe PO konservimit/restaurimit të teatrit të vjetër, duke u thënë kështu JO shkeljes së Kushtetutës dhe JO vjedhjes së pronës publike nga kryeministri dhe oligarkët e tij. Duhet të jemi krenarë për ta dhe krenarë për veten!"

ARTISTË E KALLËZIME

Reagimet veçse janë grup, kanë qenë edhe nominale si ai i Stefan Çapalikut që shkruan: "I lumtur sa s'ka, që mbas një muaj qëndrimi në Sofje, në rezidencën e shkrimtarëve dhe përkthyesve 'Next Page', arrita të

shkruaj vëllimin e tretë të romanit tim 'Secili çmendet sipas mënyrës së vet', mësoj se si në atdhe çmendet dikush tjetër, që shkruan për mua se qenkan bërë pro shembjes së teatrit".

Po dje, Aleanca njoftoi se "pas prezantimit të kallëzimit penal ndaj Hervin Çulit dhe Mirela Kubaros, do të demaskojmë dhe diskreditojmë mashtrimin e ri të propagandës shtetërore: një botim special të sajuar në minutën e fundit për të mashtruar Johannes Hahn, duke përbaltur disa artistë që janë shprehur pro restaurimit të teatrove kombëtare".

Roza Anagnosti: Më dëshpëroi votimi në parlament, mjaft me litarin për bukën e gojës

Dje në protestën para teatrove kombëtar erdhi Roza Anagnosti. Si kundërpeshë e një petitioni artistësh që duke kërkuar teatër të ri kërkojnë shembjen e këtij që është ajo përcolli pezmin e trishtimitin e gjithë kësaj kohe. "Arsyeja që kam ardhur këtu është se unë i qëndroj idesë që teatrit duhet të rikonstruktohet. Vendi ka nevojë për një teatër klasik. Më falni që nuk kam ardhur po kushtet familjare s'më kanë lejuar". U kujdes të thotë se nul është ndikuar nga partitë. "S'kam qenë asnjëherë me asnjë parti. Partia ime është arti im. Këtu është kultura identiteti e shpirti njerëzor. Ka më shumë se 50 vjet që interpretoj në këtë skenë. Unë nuk mund të rri pa dëgjuar arkitektin, shkrimtarin, të vuariturin Maks Velo. Ai s'ka asnjë arsye ta mbrojë. Apo filozofin e intelektualin Plasari a filozofin Fuga", tha ajo. Për Anagnostin nuk është keq të duash vendin tënd ndaj ajo falenderoi kolegët



Roza Anagnosti

erinj që sipas saj do të bëhen më të mirë se ajo. "Kjo ka vlera brenda e jashtë. Atë ditë që u bë votimi në parlament jam dëshpëruar jashtë mase. Unë nuk mendoj i majtë e i djathtë, janë publik. Atë ditë pas votimit, më kujtohet një foto e aktoreve sonë, Anila Bisha përkrah Besnik Bishës. A djalli i regjisorit të madh Gëzim Erebara, Rudi Erebara. Teatri është i bukur. Sa herë që vij më duhet akoma më i bukur. Kemi nevojë për një teatër klasik. Nuk mund të prishet një teatër i një shkallë zhvillimi. Jam e sintqertë dhe e them pa asnjë pra-

paskenë. Për gjuhën shqipe kemi dhënë shumë në atë skenë. I kemi bërë shqiptarët ta duan", tha Anagnosti. Më pas ajo interpretoi një tekst me mesazhe. "Shakespeare thotë se bota është një skenë. Ka shumë lloje litarësh e zinxhirësh që përdori njeriu për të shtypur njeriun, por litarin i bukës doli më i rëndë. Jo se po vuaj unë po se do jesh ti në vendin tim. Dita e sotme ishte e bukur, si gazi i fëmijës që nuk thotë ende fjalë", e mbylli ajo fjalën.

Pas saj Maks Velo tha se mbrëmë ishte emocionimi më i madh

që ka marrë. "Me siguri ajo (Roza) flet edhe në emër të Dhimitrit. Në kohën e partisë kemi bërë disa teatro. Asnjë nuk është si ky. Nuk arrin parametrat e tij. Ky ka formën e teatrove të Mesjetës me disa hapësira derisa del në sallë e pret dramën. Kur mbaron shfaqja to del ngadalë nga sallë në mënyrë që të qetësohesh. Sepse është e rëndë të dalësh menjëherë nga sallë. Kalon disa hapa e hapësira. Mënyra si e ka bërë Berte është e jashtëzakonshme. Ai palaço teatër që do jetë që ishalla nuk do jetë, nuk do jetë si ky. Ka nevojë për rikonstrukcion dhe të shkojë edhe 100 vjet të tjera", tha Velo.

Në fund Robert Budina shtoi se një makinë e madhe propagande arriti deri në këtë pikë. "Teatri e reformoi në më të voglën e vet shoqërinë. Janë 300-400 shkrimet për teatrin, ndaj teatri e bëri punën e tij. Këta jemi. Ne kemi shumë punë për të fituar demokracinë".

LIGJERATA

Federico García Lorca

(Pjesë nga ligjërata)

“Teatri është një nga instrumentet më shprehëse dhe më të dobishme për ndërtimin e një vendi dhe njëherësh barometri që shënon ngritjen ose tëposhtjen e tij. Një teatër i ndjeshëm e i mirorientuar në të gjitha degët, nga tragjedia te vodevili, mund të ndryshojë brenda pak vitesh ndjeshmërinë e një populli; ndërsa një teatër i shkatërruar, ku flitrat zëvendësohen nga kthetrat, mund të përdhosë e të vërë në gjumë mbarë një komb.

Një popull që nuk ndihmon dhe nuk nxit teatrin e tij, nëse nuk ka vdekur, është në hjekë e sipër. Ashtu edhe teatri që nuk përkap rrahjet e zemrës së shoqërisë, rrahjet e zemrës së historisë, dramën e njerëzve të tij dhe ngjyrën e natyrshme të peizazhit të tij e të shpirtit të tij, në gaz a në lot, nuk ka të drejtë të quhet teatër, por sallë lojnash ose vend për të bërë atë gjë të tmerrshme që quhet “të shtysh kohën”. Nuk e kam fjalën për askënd dhe nuk dua të lëndoj askënd, nuk flas për raste konkrete, por për problem-in e shtuar pa zgjidhje.

Dëgjoj përditë, miq të dashur, tek flitet për “krizën e teatrit” dhe mendoj gjithnjë që sëmundja nuk është para syve tanë, por e fshe-

hur në thelbin e vet më të errët; nuk është sëmundje sipërfaqësore, që lidhet me veprën dhe veprimtarinë, por sëmundje me rrënjë të thella, që do të thotë sëmundje organizimi. Për sa kohë aktorë dhe autorë do të jenë në duar sipërmarresh kryekëput komerciale, sipërmarrje të lira dhe pa kontroll letrar e shtetëror të asnjë lloji, aktorë dhe autorë, dhe i gjithë teatri tok me ta do të bjerren përditë më shumë, pa shpëtim.

Teatri duhet t'i imponohet publikut dhe jo publiku teatrit. Për këtë, aktorët duhet t'i veshin vetes, sikur ta paguajnë edhe me gjak, autoritet të madh. Sepse publiku i teatrit është si kalamajtë e shkollave: admiron mësuesin e rreptë dhe hijerëndë që kërkon dhe bën drejtësi, ndërsa mbush me gjilpëra karriget ku ulen mësuesit e druajtur dhe lajkatarë, që as japin mësim dhe as marrin.

Publikut i duhet dhënë mësim, sepse vite të shkuara kam parë të fishkëllejnd një Debussy dhe një Ravel, ndërsa kam qenë mandej i pranishëm gjatë brohoritjeve të potershme, të cilat një publik popullor u bënte veprave më parë të refuzuara. Ishin autorët që u patën imponuar nëpërmjet një kriteri të lartë autoriteti ndaj atij publiku të rëndomtë, si Wedekind në Gjermani, Pirandello në Itali dhe sa të tjerë.

Për artistët rezistentë

“Një popull që nuk ndihmon dhe nuk nxit teatrin e tij, nëse nuk ka vdekur, është në hjekë e sipër”



Federico García Lorca

Është e domosdoshme të bëhet kjo për të mirën e teatrit dhe për lavdinë dhe hierarkinë e interpretuesve. Duhen mbajtur qëndrime të denja, me sigurinë se kanë për t'u shpërblyer, madje me të tepërt. E kundërta është të dridhesh nga frika mbrapa kuintave dhe ta vrasësh fantazinë, imagjinatën dhe magjepsjen e teatrit, që është

të gjithnjë - gjithnjël - art dhe do të jetë gjithnjë art sipëror, ndonëse pati një epokë kur quhej art gjithë sa na pëlqente, për të prishur atmosferën, për të shkatërruar poezinë dhe për ta bërë skenën një dabëllhanë.

Art përmbi gjithçka. Art shumë fisnik, ndërsa ju, të dashur aktorë, jeni artistë për-

bi gjithçka. Artistë nga koka te këmbët, përderisa nga dashuria dhe pasioni jeni ngjitur në atë botë trillane e të dhimbshme që quhet skenë. Artistë për nga okupimi dhe preokupimi. Që nga teatri më modest, deri te më madhështori duhet shkruar fjala “Art”, në sala dhe në kamerina, sepse përndryshe do të na duhet të vëmë fjalën “Tregti” ose ndonjë fjalë tjetër që nuk ma nxë goja.

Unë pres gjithnjë për teatrin ardhjen e dritës prej së larti, prej Parajsës. Kur ata të së lartave të zbrisin në ndenjset e platesë, gjithçka do të zgjidhet. Dekadencia e teatrit mua më duket budallallëk. Ata që janë lart, nuk kanë parë Otellon, as Hamletin, asgjë prej gjëje, të gjojtë ata! Ah si do të dinë të shohin kur t'i shohin! Kam parashikuar në Alikante se si gjithë një fshat do të mbante radhë për të parë një pjesë nga kulmi i teatrit klasik spanjoll: “Jeta është ëndërr” të Calderonit. E ndjenin dhe ç'të ndërje! E pra për ta kuptuar atë nevojiten gjithë dritat e teologjisë. Nuk e kishte gabim Molière-i që ia lexonte më parë pjesët e veta kuzhinierës.

(Përthetur dhe përgatiti, Aurel Plasari me shënimin: Nganjëherë harrohet që Lorca pati qenë jo vetëm autor dramash, por edhe regjisor dhe madje themelues e drejtues i një teatri eksperimental “universitar”. Nga: Federico García Lorca. Charla sobre teatro, 2 de febrero, 1935, d.m.th. një vit para vrasjes.)

ZJARR E UJË/ RAPORTI I INXHINIERËVE TË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT: BIBLIOTEKA “NOTON”

Instituti i Ndërtimit ka dorë zuar më në fund një vlerësim teknik për Bibliotekën Kombëtare një muaj pas përmbytjes dhe një vit pas zjarrit. Ekspertët vënë në dukje se impianti i mbrojtjes nga zjarri ka nevojë për ndërhyrje të thella rikonstruktive dhe se mungon hidrolizimi i bazamentit të themeleve, si dhe i faqeve anësore të bodrumit.

Raporti i detajuar i Institutit të Ndërtimit shkon në 50 faqe dhe përfillon atë që specialistët e Bibliotekës Kombëtare kanë thënë prej kohesh: “Kushet në të cilat ruhet kujtesa e shkruar kombëtare janë në degradim e sipër”.

Në një prononcim për “Top Channel”, drejtoresha e Bibliotekës Kombëtare, Persida Asllani thotë se “ajo çka lexojmë nga ky raport na qartëson për rritjen e nivelit të ujërave nëntokësore në këtë zonë dhe për amortizimin pa kthim të vetë ndërtesës. Shqetësimi kryesor në këtë lexim është fakti që prania e ujit, sado në centimetra të ulëta, mund të përsëritet gjatë stinës së reshjeve intensive”. Për të shmangur një përmbytje të dytë, specialistët sugjerojnë vendosje të sensorëve që detektojnë lagështirën, ventillime të fuqishme, aparaturë që ulin artificialisht përqindjen e lagështisë në ajër, si edhe një hidrolizim të menjëhershëm.




Por kjo është një zgjidhje afatshkurtër, nëse librat vijojnë të mbeten në të njëjtën godinë. Për një zgjidhje afatgjatë, drejtoresha e Bibliotekës i bie edhe njëherë së njëjtës kampion alarmi, tingullin e së cilës kërkon tashmë prej kohësh që të dëgjohet.

Vjetërsia dhe dëmtimet që ka pasur objekti në dyshtim e tij sikundër mungesa e masave mbrojtëse, që prej projektimit janë sipas Institutit të Ndërtimit, arsye kryesore që ka ndodhur evadimi i ujërave në ambientet e bodrumëve të Bibliotekës. Në ekspertizë faji kryesor i dëmtimit të shiut në Bibliotekë është i mungesës së studimeve hidrologjike dhe i masave mbrojtëse për hidrolizim të objektit për këtë zonë që gjatë projektimit të ndërtesës. Fenome-

ni i daljes së ujit në dyshtim e objektit, sipas specialistëve të shtetit ka ardhur si rezultat i rritjes së nivelit pjezometrik të zonës. Sipas ekspertëve, Biblioteka në themelet e saj, në shtresat e dyshtimit ka pësuar dëmtime dhe nuk e ka mbrojtur praninë e ujërave nëntokësore.

Viti 2017-2018 ka pasur reshje të mëdha dhe sezoni i tyre ka filluar shumë shpejt. Sot aktualisht gjendemi në kuotën maksimale të ujërave nëntokësore dhe si rezultat i reshjeve të mëdha në sasi dhe në një kohë të shkurtër (në ditët që ndodhi përmbytja), është rritur prurja dhe niveli pjezometrik i zonës, ku ndodhet edhe tabani i themelet të Bibliotekës. “Zgjidhja e vetme do të ishte një vizion shumë i qartë dhe jo më hezitues.



Imediate është marrja e vendimit për ndërtimin e një Biblioteke të re Kombëtare. Ndërtimi i një biblioteke të re do të lejonte përllogaritjen që në projekt të gjitha parametret të nevojshme që duhen për një Bibliotekë Kombëtare. Paralelisht me këtë, ka ardhur koha që funksionet e Bibliotekës Kombëtare të ndahen nga funksionet publike të Bibliotekës së Tiranës. Kryeqyteti ka nevojë, që për 1 milion banorët e tij, të ketë një bibliotekë të vetën”, thotë Persida Asllani.

Ekspertët theksojnë se objekti nuk plotëson standardet dhe ka një amortizim të tejskajshëm, ndaj rekomandojnë të merren masa të menjëhershme, duke larguar materialet nga soletat për të bërë uljen e ngarkesës dhe le-

htësimin e tyre, duke kryer provat laboratorike për strukturat si karrotazhe, sonografi, tomografi. Kryerjen e spektakrave të momenteve për strukturat si edhe kërkojnë marrjen e masave të menjëhershme për hidrolizim të nevojshme, në ambientet e bodrumëve të objektit, apo shtirimit e shtresave të dyshtimeve, pasi janë jashtë çdo kushti teknik. Njëherësh, në raport, ata kërkojnë që të bëhet heqja e suvatimeve të vjetra, pasi janë tejet të degraduara dhe të zëvendësohen me të reja. Duhet bërë ndërhyrje totale, mbi bazën e një projekti të studiuar, për rritjen e performancës së strukturave si dhe rifiniturës së vetë ambienteve.

Opinion i Ditës

Pse ikin shqiptarët?

Nga Besnik Bakui

(vizon nga faqja 1)

... analizimin e tyre mbi lëvizjet migratore të shqiptarëve. Prej tyre doli se afro 40 për qind e popullsisë së Shqipërisë jeton jashtë vendit. Po t'i bashkëngjites këtyrë studimi edhe atë të "Gallup-it", ku gati gjysma e qytetarëve sot duan të largohen nga Shqipëria, apo shifrat e aplikimeve për lotarinë amerikane, gjendja paraqitet aq alarmante sa mund të shprehemi se pakkush e sheh të ardhmen e tij dhe të femijëve në Shqipëri, se askush nuk dëshiron më të jetojnë në këtë vend. Ndonëse duket se jemi të vonuar të konstatojmë, nuk është kurrë vonë t'i analizojmë këto të dhëna, për të kërkuar dhe sugjeruar zgjidhje, sa jemi ende në kohë dhe para se vendi t'i ngajë tokës së shkretuar, ku edhe bari refuzon të mbijë. Një atdhe i zbrazur nga populli i vet është jetim.

Shqiptarët largohen me "amok" drejt një jete të re, më të mirë me gjasë. "Më keq se sa jemi, nuk mund të bëhemi!", shprehen disa prej tyre. Këtë e shikojmë dhe e ndjëm të gjithë ne që kemi mbetur ende brenda 28 mijë km², sikur ky territor të ishte jo vendi ynë, por një çark. Po largohen të gjithë. Mjekët dhe infermierët, të joshur nga "oferta gjermane" për punësim, pagës dhe dinjitet më të mirë, po braktisin spitalet tona duke e venë në krizë dhe dilemë edhe vetë "betimin e Hipokratit". Në këto përmasa, jo larg nga sot, në spitalet tona shtetërore do të mungojnë mjekët specialistë vendas dhe shqiptarët do të detyrohen t'u drejtohen vetëm spitaleve private.

Po largohen edhe inxhinierët më të aftë, specialistët e bujqësisë e të blegtorisë, po largohen teknikët, mësuesit dhe mjeshtret e zanateve, pasi emigracioni ka mbetur e vetmja rrugëzgjdhje për t'u siguruar atyre vetë, femijëve të tyre një jetë më të mirë. Me të drejtë, miku im, poeti Xhevahir Spahiu lëshon klithën/apel: "Iku truri/mbeti kafka/dhe huri/iku truri".

Njerëzit nuk shohin ndonjë rrugëzgjdhje tjetër përballë varfërisë dhe papunësisë që ka mbërthyer thuajse të gjitha familjet shqiptare, e cila nuk është pjesë e "tavës" dhe që nuk gëzon përkrahjen e ndonjë politikani apo pushtetari. Po atëherë, kur nuk paskemi të sigurt asgjë dhe kur qëllimi i jetës qenka largimi nga vendi, përse na u dashka shteti si rregullator, përse i paguanë detyrimet tona dhe taksat, kur shteti ynë nuk na përgjigjet për asgjë?

Dhe të mendosh se proceset demokratike në Shqipëri kishin si moto "E duam Shqipërinë si gjithë Evropa!", tingëllon në paradoks i plotë. Por kjo ëndërr u zbeh e u çngjyros shpejt. E gjithë energjia u transferua në një ikje masive, mes panikut të të ndenjrit në atdhe dhe shpresës për të gjetur një kafshatë bukë më shumë, si në kushtet e mbijetesës. *Më mirë në fund i tmerrshëm se sa një tmerr pa fund*, është thënë prej kohësh, por edhe fundi i tmerrshëm, që më pas të filloi përmirësimi, nuk po duket gjëkund.

Pritshmëria nuk mund të vazhdojë pa fund, pasi kjo jetë nuk është



të Purgatori, ku shpirtrat presin derisa të merret vendimi. Pritja dhe durimi janë pjesë e kësaj bote. Derisa mirëqenien e kanë arritur shumë të tjerë para nesh, duhet të gjejmë rrugëzgjdhjen se çfarë nuk funksionon në mekanizmin tonë shoqëror. *Pritshmëria* quhet punë, siguri, mirëqenie, besim. *Njerëzit duan punë dhe punë s'ka*. Kjo është e vërteta që nuk duan ta pranojnë ata që kanë marrë përsipër të krijojnë politika efikase punësi. *Njerëzit kërkojnë shpresë, e shpresë nuk ka*. *Kërkojnë dritë në fund të tunelit dhe nuk ka tunel fare, vetëm një mur i ftohtë dhe i heshtur*. Një "mal që s'bëzan".

Dikush përpiqet ta justifikojë këtë situatë dhe realitet "oruellian" me faktin se lëvizja e lirë, migracioni dhe emigracioni është një fenomen global dhe i vjetër sa vetë njerëzimi. Po, janë argumente të sakta dhe të vërteta, por unë mëndoj se kryefjala e largimit të shqiptarëve nuk është kjo, por zhgënjimi. Varfëria, mashtrimi, mospërfaqësimi, papunësia, mungesa e shpresës.

Vërtetë emigrimi masiv i shqiptarëve është një fenomen historikisht i njohur, si në atdheun nënë, ashtu edhe në trojet tona jashtë kufijve natyrorë të Shqipërisë. Duke iu kthyer kujtesës, sjellim ndër mënd se shpërnguljet e para drejt Perëndimit, që fillojnë në shekullin e XV, pas pushtimit otoman dhe rënies së epokës skënderbeiane. Ato emigrime vijuan edhe në kohërat moderne, në fillim të shekullit XXI dhe sidomos në shekullin XX, ku mund të kujtojmë vitet 1914, 1924, për të kulmur me zërkullimin bibliotik të shqiptarëve drejt brigjeve italiane në vitet '90 apo gjatë vitit të mbrapshtë 1997.

Pas procesit të liberalizimit të vizave, ky fenomen duket sikur u kufizua, por a ishte ky një iluzion? Tashmë fenomeni emigracioni është të rilindur, ndaj vazhdojmë të pyesim dhe të kërkojmë "pse"-të, pasi eksodi i pashpallur i periudhës së fundit ka kapërcyer çdo parashikim, duke rrezikuar zbrazen e vendit.

Pse po largohen shqiptarët? Personalisht (pavarësisht nga ato që broçkullisin politikanët) mëndoj se dëshmiti 28-vjeçar i proceseve të integrimit është arsyeja pse shqiptarët dhe veçanërisht të rinjtë po largohen nga vendi. Ata nuk shohin perspektivë. Madje, ka dalë një thënie se: "Nëse BE nuk vjen tek ne, atëherë shkojmë në tek

ajo".

Rruga për integrimin në Bashkimin Evropian që na është servirur si "Tokë e Premtuar" është akoma e gjatë dhe e papërcaktuar qartë. Deri kur do të vazhdojmë këtë rrugëtim "nëpër shkretëtirë"? U dashkan 40 vjet? Endrra evropiane herë-herë i ngjan "mollës së ndalume". Kur kujtojmë se jemi më afër me BE-në, aq më pak realiteti politik dhe social, i zhytur në zhgënjim, korrupsion dhe padrejtësi, i përngjan "zhgëndrës evropiane". Integrimi nuk po shihet më si shpresë për përmirësim, por si e vetmja mundësi për të ndaluar degradimin.

Shqiptarët ikin se duan të jetojnë si evropianë jo vetëm nga ana gjeografike, por edhe nga ana materiale, shpirtërore e kulturore, pasi siç shkruan edhe Paul Valéry: "Është absolutisht evropiane gjithçka që vjen nga tri burimet: Jerusalem, Athinë e Romë". Dhe shqiptarët (duan apo nuk duan politikantët) jetojnë në shekuj të rrjedhën e këtyre tri burimeve, nga të cilat sot kemi pasuri e krijimtari të shumta, pjesë të trashëgimisë kulturore kombëtare.

Shqiptarët ikin, se u lodhën me paaftësinë e "elitave" për të bashkëpunuar mes njëra-tjetrës dhe për ta shtyrë përpara vendin drejt integritimit. U lodhën me barrikatad partiake, ku njëra palë flet e mburret për sukses të papara më parë dhe pala tjetër thotë që jemi në një ferr të vërtetë; ku nuk ka bashkëndarje dhe mënyrë demokratike e të sinqertë të zgjidhjes së problemeve, por vazhdon monologu. Bashkëpunimi duket "mission impossible". Një nga themeluesit e lëvizjes analitike të filozofisë anglo-amerikane, Bertrand Russell thoshte: "E vetmja gjë që do ta shpëtojë njerëzimin është bashkëpunimi". Ky bashkëpunim jo vetëm do të shkurtonte kohën e integrimit, por do të mbyllte njëherë e mirë plagët. Por "elitat" tona të katapultuara (nëse mund të quhen të tilla) me paaftësinë e tyre dhe mungesën e konsensusit politik edhe për probleme madhore të shoqërisë shqiptare vazhdojnë akuzojnë njëra-tjetrën me epitetet nga më kriminalet. Ato grabitën pasurinë publike, legalizuan kulturën e mosndëshkimit dhe kriminelizuan shoqërinë. Në vend ta shpëtonin këtë vend, ato e groposën thellë e më thellë, në kufijtë e degradimit.

Shqiptarët ikin për t'i shpëtuar

rrëzikut të degradimit, ku një "meritë" migjeniane, për këtë ikje ka edhe faktori ndërkombëtar, i cili më shumë se për mirëqenien dhe demokracinë, ka theksuar stabilitetin. Madje, janë ata që shpikën enkas edhe termin Asocim-Stabilizim.

Si mund të harrojnë shqiptarët mbështetjen që aktorë të fuqishëm ndërkombëtarë (organizma, apo politikanë) i kanë dhënë jo rrallë pushtetarëve autoritarë, apo institucionet të dala nga zgjedhjet e manipuluar. Nuk ka ngulur drejtës të këtyrë shteti në këto 28 vite, që nuk e kanë etiketuar si "burrë shteti", madje në jo pak raste pas ngjarjeve tragjike që kalonim ne shqiptarët e thjeshtë.

Shqiptarët ikin se biznesi kryesor në Shqipëri vijon të jetë politika dhe politika si burim biznesi, e ka thuajse të pamundur të prodhojë politika pozitive për shumicën qytetare në nevojë. Informaliteti, korrupsioni, monopoli i marrin frymën ekonomisë paralizojnë zhvillimin. Shoqëria jonë sot nuk ka kohezionin e durimit social, mungon mirëkuptimi i ndërsjellë dhe formimi i vullnetit kolektiv. Pabarazia sociale sa vjen e thellohet, duke rëndur drejt greminave. Dihet mirë se ku të shpie pabarazia. Ajo pjell indoktrinimin e qytetarëve me ideologji të mbrapshta, zhvlerëson vlerat e demokracisë dhe shkatërron çdo shpresë dhe besim. Me të drejtë, znj. Alina Mungiu-Pippidi, eksperte e mirëqeverisjes për institucionet e BE-së, radhit korrupsionin si një nga shkaktarët kryesorë të emigracionit: "Një arsye kryesore pse njerëzit largohen nga vendi i tyre, me përjashtim të një lufte civile, është... kur shoqëria nuk është e bazuar mbi meritat".

Shqiptarët ikin, se në Shqipëri ka vetëm dy standarde të të jetuari: niveli "Manhatan", ku jetojnë njerëzit e politikës dhe të medieve dhe niveli "geto", ku duhet të jetojnë shqiptarët e tjerë. Të parët kanë humbur sensin e ndjeshmërisë dhe të reagimit, kanë humbur përgjegjësinë qytetare dhe të detyrimit publik në raste të tilla. Si ka mundësi që atje ku ka krom, ka varfëri madje ekstreme?! Atje ku ka naftë, ka të papunë?! Atje ku ka ujëra, pyje dhe burime natyrore përallorë, po atje ka varfëri!

Shqiptarët ikin, se klasa politike në këtë çerekshkulli në post-diktaturë, në mënyrë më paradoksale ka krijuar hendek të madh me

qytetarët, sidomos me ata në nevojë dhe ka humbur sensin e reagimit, përgjegjësisë dhe detyrimit në raste të tilla. Ato kanë hapur një gropë ku një ditë do të biem të gjithë brenda. Në shoqëritë informale është e domosdoshme që shteti të tregojë karakterin e tij represiv, por krahas saj duhet edhe një fytyrë humane e tij, një imazh më paternalist është i nevojshëm. Shteti duhet të përdorë në masë proporcionale kërbacin dhe ku-laçin.

"Ndiheh e pasur - thotë kancelarja gjermane Angela Merkel - kur populli im ka një ekonomi, arsim, shëndetësi të fortë, si edhe drejtësi e barazi për të gjithë".

Shqiptarët ikin, se tregu politik shqiptar është mbushur me shpifje, sharje, akuzë dhe kundërrakuzë. Kudo prurje toksike të politikës shtohen përherë e më shumë, ato vetëm ndotin mjedisin më shumë se plehrat dhe mbeturinat, të cilat njerëzit i hedhin në kazanë. Këto "mbetje toksike" që prodhohen me shumicë nga politika nuk hidhen në kazanë, nuk ka impiante për t'i përpunuar, ato shpërndahen në mjetet e informimit dhe i ofrohen publikut si ushqim shpirtëror.

Shqiptarët ikin, se është e vështirë t'u ngjallësh shpresën edhe duke sjellë në vëmendje të madhin Martin Luter King, i cili edhe pse në kushte shumë më të vështira, apelonte: "Motra dhe vëllezër, të mos biem në humnerën e dëshpërimit. Edhe pse po përballimi me vështirësi të mëdha, unë ende kam një ëndërr", që ne shqiptarët e thjeshtë të vazhdojmë me sforcë ëndrën e viteve '90, për të ardhur dita të jetojmë në një Shqipëri, ku jeta është më e mirë, më e begatë, më e sigurt, më e kënaqshme, me mundësi për këdo sipas arritjeve ose aftësie.

Për të parandaluar ikjen e shqiptarëve është domosdoshmëri zbatimi i një politike apo shumë politikave bashkëpunuese e të gjithëpranuar kundër tiranisë, varfërisë dhe pabarazisë, si arsyet më të rrezikshëm të shoqërisë shqiptare.

Sot jemi në emergjencë për të "dekriminalizuar varfërinë", pasi çdo qenie humane në çdo cep të botës nuk mund të rinte e qetë kur vë në gjumë femijët pa ngënë një copë bukë. Ajo do dilte rrugëve dhe ku të mundte të lypte, të kërkonte në plehrat, të thyente, të vidhte. Është në të drejtën dhe detyrimin biologjik të saj të bënte gjithçka. Nuk është krim çfarëdo të bësh për të gjetur bukë për femijët.

Është e domosdoshme që ky vend të qeveriset, siç shkruan miku im, profesori dhe shtetari i nderuar Ylli Çabiri: "... problemi themelor i Shqipërisë nuk ka qenë krimi i organizuar, por shteti i çorganizuar. Krimi, trafik, varfëria, papunësia, droga, mungesa e drejtësisë janë para së gjithash pasoja të qeverisjes së çorganizuar. Problemi nuk është thjeshtë të përmirësojmë qeverisjen. Reformimi thelbësor dhe sa më i shpejtë i qeverisjes duhet të jetë mbireform! Pa reformuar qeverisjen, nuk mund të realizohet asgjë dhe ky është një parakusht i domosdoshëm për çdo reformë e ndryshim tjetër...".

Opinioni *i* Ditës

A varroseshin shqiptarët?!

Nga Ben Andoni

(vijon nga faqja 1)

...i gjithë grupi i turistëve të huaj priste pa pipëritë përgjigjen time. Nuk e mohoj se më befaso i me pyetjen, por më shumë kinse naivitetin që mbante pak si shumë erë keqdashje. Heshta një moment. Doja t'i kthehesha keq, por kështu do t'i jepja 'një provë' më shumë për ne shqiptarët 'e pagdhendur'. - Po të përgjigjem me një pyetje, i thashë. - Ku mund t'i çonim në gjykimin tuaj të vdekurit, kur e mbyllim udhëtimin e jetës?!". Topitja e turistëve u kthye pakëz në ilaritet mes grupit dhe situata u kalua disi, por jo makthi tek shoqëruesi i vjetër, që tregon një situatë të zakonshme me grupet e shumta të turizmit, që vinë sot në Shqipëri.

Shqipëria në sytë e të huajve vjen sërish përmes një propagande, që duhet thënë se nuk është gjithëherët miqësore. Veç stereotipit të shqiptarit shpërndarës droge, bandit, hajdut dhe më së shumti vrasës, që shoqëron episodet në filma, kemi shqiptarin e çakorduar dhe pa sens i etur për rrëmujë dhe pa rregullat bazikë të qytetërimit. Kinematografia e huaj e ka ushqyer mirë, kurse shkrimet e shumë artikullshkruesve vendës e të huaj e kanë konfirmuar këtë shpesh në mënyra krejt hipotetike. Mjafton një rast kundërdravajtje i rëndomtë, që të shumëzohet paraqitja e shqiptarit të pa-përgjegjshëm dhe të destinuar për të bërë keq dhe tollovi. Ka kaluar disi zhurma e periudhës së trafikut të femrave, por shqiptarit i janë veshurtribute të reja, atij të transportuesit rëndom të drogës dhe shpesh vrasësit. I gjithë ky peizazh i tanishëm social i vshitet atij të shkuar, për të cilin mungonin realisht referencat veç hamendësirave. Ndaj, pyetjet e të huajve që vinë përherë e më shumë në Shqipëri, jo pak herë janë nga më të habitshmet. A kishit televizor në socializëm?! A bënit pushime? Keni pasur universitet? A ishte e vërtetë që hanit bashkë të gjithë në një pjatë të madhe? A rrinin të ndarë burrat dhe gratë? Keni pasur teatër? Miku ynë, që tashmë në pension bën guidën, të rreshton pyetje pa fund të turistëve që të trembin me mungesën e njohjes, por edhe fuqinë e errët të propagandës, bërë dhe vazhdon të bëhet ndaj Shqipërisë. Ndonëse kanë kaluar vite dhe dekada, ajo është e pranishme në grupet turistike dhe nëse do të bëhej një vështrim sociologjik, do kishite përfundime interesante. Ajo përshkon individë të tërë në bрезat e ndryshëm të vendeve të huaja, forcën e një propagande shumë malinjë, por edhe stereotipat me të cilat shikohet vendi ynë. Për fat, një pjesë e guidave e përballon ngarkesën, mbi të gjitha pyetjet, nga përgjigjet e të cilave ka shumë se çfarë mund të kuptohet për vendin tonë.

Po a ndodh kështu me të gjithë?! Një pjesë e guidave, në fjalën e mikut tonë që e referuam më sipër,



në mungesë të kulturës së përgjithshme të mjaftueshme, rekrutimeve të shpejta, moshës së re, por edhe cinizmit të zakonshëm të shqiptarëve ndaj vendit të tyre nuk lënë gjë pa thënë për Shqipërinë. Për ta: Shqipëria e para viteve '90 është një grupë e zezë, ashtu si ajo e viteve të para të demokracisë. Shqiptarët kanë bërë thjesht luftë civile! Luftë antifashiste s'ka pasur fare. Të dhënë pas drogës. Gomonja është fare normale. Vitet e socializmit kanë qenë të errëta dhe shkolla ishte shumë e dobët. Shqetësimi më i madh, citoj burrin e vjetër, është se këto fjalë amplifikohen në masë nga turistët e huaj, kur shkojnë në vendet e tyre dhe janë përcaktimet e para sesi komunikohet për vendin tënd nga vizitorët. Po a është mirë ta kritikosh vendin tënd? Në një farë mënyre po, nëse në vendin tënd shkelen të drejtat e njeriut dhe kemi sundim të një kaste apo ku padrejtësia është sheshit ndërsa mundësia e njerëzve është shumë e vogël për ndryshim. Përkundrazi, nëse një vend është në rrjedhën e vet të ndryshimit, atëherë ndryshimi u takon qytetarëve dhe ata kanë mundësi të testojnë veten e tyre me zgjedhjet dhe formacionet politike që përkrahin. Asnjë vend nuk është i përsosur për qytetarët e vet. Amerika, si një vend që ka luftuar shumë për demokracinë, e ka të sanksionuar në Deklaratën e Pa-

varësisë, mundësinë e ndryshimit, nëse parametrat e demokracisë degjenerojnë. Shqipëria, në udhën e vet të ndryshimit, duhet të kuptojë se ky stad nuk na pengon të gjykojmë realisht për nivelin tonë të demokracisë dhe se rregulli dhe logjika duhet të sundojnë. Përgjatë edhe demokracive më të zhvilluara ka pasur probleme zhvillimi apo liderë me të cilët popujt e tyre s'ishin dakord dhe reforma joproduktive, por në to vepron thjesht: ndryshimi vjen me zgjedhje të ndryshme dhe me emërimin e njerëzve më të mirë. Një vend e drejtojnë njerëzit që i nxjerr vetë dhe kjo është shumë me e mirë sesa të shkosh e të bësh tollovi dhe mbi të gjitha të nxish aty ku duhet e s'duhet vendin tënd. Ndaj, kushdo qoftë që i është dhënë e drejta të flasë për vendin: kritiko, protesto dhe përfshij në kundërshtim, por mos e mohu vendin tënd dhe mos e nxi!

Ndodh që ky grupim i ri, që mund të futet në industrinë e turizmit di të flasë bukur për natyrë, por shumë pak për anën tjetër, duke i lënë të huajt me hamendësi nga më të habitshmet, por edhe pa përgjigjet e duhura. Teksa, shkollimi i mangët i këtyre tri dekadave po ndikon edhe në këtë aspekt. Të rinj që flasin mirë gjuhë të huaja, por që çalojnë në kulturë të përgjithshme, sidomos në atë që lidhet me fazat e zhvillimit të ven-

dit shprehin lloj-lloj gjërash për vendin e tyre, u mungon formimi bazë për të parë në mënyrë krahasuese atë që është bërë në shekullin e shkuar dhe rrugën sesi u zhvillua kombi shqiptar.

Në një farë mënyrë, kjo tendencë e ka bazën edhe në inflacionin e fjalës, por edhe në tollovinë sesi sot kategoritë e ndryshme flasin për vendin e tyre. Në parlamentin shqiptar, një masë e madhe e ligjvënësve ka hedhur balltë mbi të gjithë atë që është arritur, për të mos thënë që shumë nga arritjet tekniko-shkencore dhe kulturore të vendit as nuk përmenden fare, për të mos thënë që injorohen. Media me amullinë e vet e shton këtë patologji, ku të gjithë bëjnë garë se kush gjen gjëra më të këqija për vendin, pa ditur se të gjithë dëmtojmë, pasi në një farë mënyrë amplifikojn atë që thuhet për shqiptarët: të çorientuar dhe predispozuar për krimin.

...
"Ne kemi rituale të jashtëzakonshme sa i përket vdekjes, por edhe kulturë funebre. Ju mjafton të ndiqni koleksionet e fotove historike të shikoni traditën", iu përgjigja turistit, që ndërkohë kish heshtur më shpjegon burri. Por, nëse kjo pyetje do t'u bëhej nxirësve të Shqipërisë, çfarë do të thoshin vallë? Do të ngrinin supet apo kush e di duke u përgjigjur me pyetje: A varroseshin shqiptarët?!
"Gazeta shqiptare"

HOROSKOPI

DASHI
Meditimi dhe joga duhet të praktikohen për përfitimë shpirtërore, si dhe fizike. Situata financiare do të jetë e rrezikshme, prandaj të gjitha investimet duhet të bëhen me kujdes të madh. Kaloni më shumë kohë me fëmijët tuaj.

DEMI
Emocionet e forta dhe shpërthyes mund të dëmtojnë sistemin tuaj nervor, prandaj duhet t'i kontrolloni. Do të kenë një dëshirë të theksuar për të udhëuar dhe për të shpenzuar para, por tregohuni më të matur në këtë drejtim.

BINJAKET
Forca juaj e brendshme do t'ju mbështesë për ta bërë ditën e mrekullueshme në punë. Duhet të kujdeseni më tepër, nëse jeni duke planifikuar një udhëtim sot. Ndërhyrja e të tjerëve do të sjellë shqetësime në jetën tuaj martesore.

GAFORJA
Një punë e rëndësishme do të ndalet për shkak të pozicionit të zymtë financiar. Mosmarrëveshjet me fëmijët tuaj do të ishin zhgënjyese, ndaj shmangini ato. Planet për të takuar një mik pas një kohe të gjatë mund të rezultojnë një zhgënjim.

LUANI
Përpuni të jeni mendjehapur ndaj emocioneve pozitive, sikurse dashuria. Pasi këto emocione të marrin komandën e plotë, mendja automatikisht përgjigjet pozitivisht në çdo situatë. Një marrëdhënie e re do të jetë e gjatë dhe shumë e dobishme për të lindur në shenjë tuaj.

VIRGJERESHA
Dikush me të cilin jetoni do të mërzitet, nëse i keni shpërfulltur detyrat tuaja shtëpiake. Një udhëtim do të nxisë lidhjen romantike. Gjithçka duket në favorin tuaj sot në punë. Nëse udhëtoni, sigurohuni që të mos harroni të gjitha dokumentet e rëndësishme.

PESHORJA
Mbani nën kontrolli peshën dhe mos e teproni me ushqimet. Sot mund të merrni komplimente në punë. Ditë e shërbetë për funksionet sociale dhe marrëdhënie e mirë me miqtë.

AKREPI
Stili i jetesës suaj ekstravagante mund të shkaktojë tensione në familje. Ju do të jeni në sinkronizim me rrahjet e zemrës së partnerit tuaj. Partnerët e biznesit sillen përkrahës ndaj juaj. Martesa është një bekim dhe sot ju do ta përjetoni atë.

SHIGJETARI
Përmirësimi i shëndetit duhet të jetë një çasthje ditë. Një romancë është në rrugën tuaj, ndërsa një miqësi mund të bëhet më e fortë. Dikush mund t'ju bezdisë në punë, prandaj bëhuni gati të reagoni me qetësi.

BRICJAPI
Jini optimistë dhe shikoni anën e ndritshme. Pritshirësit tuaja të sigurta hapin derën për realizim e shpresave dhe dëshirave. Sot humbet financiare duken të mundshme, nëse besoni fjalët e të tjerëve.

UJORI
Bë kujdes me shëndetin, pasi rezistenca juaj do të jetë e dobët. Udhëtimet për disa do të jenë stresuese, por financiarisht janë të mira. Aftësia juaj për të vepruar me shpejtësi ndaj problemeve do t'ju sjellë mirënjohje.

PESHQIT
Sjellja juaj e vrazhdë do të shkaktojë zhgënjim tek të tjerët. Është koha për t'u treguar më i sjellshëm, veçanërisht me njerëz që ju kanë ndihmuar. Rritja e papritur e shpenzimeve do t'ju shkaktojë shumë stres.

Tragjedia në Atika të Greqisë, shkon në 84 numri i viktimave

Gjashtë shqiptarë dalin nga spitali, 1 në gjendje të rëndë

Raportohen edhe dy gra të zhdukura, familjet në ankth

Gjashtë shqiptarët e prekur nga tragjedia që u mori jetën 84 vetëve në periferi të Athinës kanë dalë nga spitali. Lajmin e konfirmon ambasada shqiptare në Greqi, ndërsa shprehen se vetëm një shtetas shqiptar, 60-vjeçari Viktor Cenko, me origjinë nga Narta ndodhet në gjendje të rëndë në reanimacionin e spitalit Evangelismos në Athinë. Ai ka djegie të shkallës së tretë në mbi 85% të trupit. Raportohet gjithashtu se edhe dy gra me origjinë shqiptare rezultojnë të zhdukura, por ky lajm mbetet i pakonfirmuar zyrtarisht. Mes anktit, familjarët të dëshpëruar nuk dinë ende asgjë rreth fatit të të dashurve të tyre, ndërsa ende nuk ka një numër të saktë të personave të zhdukur. "Zougla.gr" shkruan se zëdhënësi i zjarrfikësve, Stavroula Malki, u kërkoi të afërmeve të personave të pagjetur që të paraqiten pranë Laboratorit të Shërbimit Ligjor në Universitetin e Athinës për t'u informuar mbi procedurën që duhet ndjekur lidhur me



identifikimin e viktimave, ndërsa atyre do t'u merret edhe një mostër e ADN-së.

Deri më tani janë identifikuar përmes ADN-së 10 trupa të pajetë.



BILANCI TRAGJIK
Me kalimin e orëve, bilanci i viktimave sa vjen e

rritet. Zyrtarisht numërohen 84 viktimë, rreth 200 të lënduar, ndërsa qindra të

tjerë rezultojnë ende të zhdukur. 11 persona janë në gjendje të rëndë shëndetësore në spitalet e Athinës, gjendja e tyre sa vjen e përkeqësohet. Një tjetër trup i shkruaruar u gjet në oborrin ku u gjetën 26 trupa të karbonizuar, të përqaftuar me njëri-tjetrin. Ekipet e emergjencave janë ende në garë me kohën për gjetjen e të zhdukurve, por shpresat mbeten të pakta. Nisur nga numri i lartë i personave të zhdukur, mediat në Greqi raportojnë se bilanci mund të jetë edhe më i rëndë, mbi 100 viktimë. Në total numërohen mbi 750 shtëpi të djegura. Në një vizitë në fshatin Mati, ministri i Brendshëm grek, Panos Kamenos, u përball me zemëratën e banorëve për reagimin e ngadaltë të shtetit dhe mungesën e një plani emergjence.

Nga zjarri të përmbytyt, Atika gdhiet nën ujë

Ende e parimëkëmbur nga gërmadhat që la zjarri masiv, Greqia po përballet me një tjetër katastrofë, atë të stuhisë së shirave që kanë pushtuar rajonin e Atikës. Autoritetet mbeten në ankth, pasi zonat e shkatërruara nga zjarri mund të përmbyten, për pasojë mbledhja e viktimave bëhet edhe më e vështirë. Paralajmërimi vjen nga autoritetet bullgare, të cilat bëjnë me dije se Greqia dhe Turqia mund të përballen me përmbytje pas reshjeve të mëdha që priten të tejfryjnë shtretërit e lumenjve Arda dhe Maritsa, që rrjedhin në territoret e tyre. Ministria e Jashtme bullgare ka njoftuar se diga Ivalilovgrad, në lumin Arda, që rrjedh në lindje të Greqisë, ka shumë gjasa të tejmbushjet nga shirat që mund të bien gjatë ditëve të ardhshme. Vetë autoritetet bullgare kanë shpallur gjendjen e emergjencës në disa bashki pas shirave të rrëmbyeshëm, ku një person humbi jetën pasi u rrëmbye nga ujërat e përmbytjeve. Edhe në korrik të vitit të kaluar Gre-



MINISTRIA E JASHTME BULLGARE

Diga Ivalilovgrad, në lumin Arda, që rrjedh në lindje të Greqisë, ka shumë gjasa të tejmbushjet nga shirat që mund të bien gjatë ditëve të ardhshme. Vetë autoritetet bullgare kanë shpallur gjendjen e emergjencës në disa bashki pas shirave të rrëmbye nga ujërat e përmbytjeve.

qia u godit nga një stuhi e fortë duke bërë që autoritetet të evakujnë dhjetëra persona në disa zona të Se-

lanikut, ndërsa shumë hotele dhe makina u përmbyten nga reshjet e rrëmbyera.

Flet Petrit Athanasi: Gjendja, shumë e vështirë

Një shqiptar "hero", po ndihmon me ushqime banorët e Atikës


Tragjedia e rëndë që preku Greqinë, ku zjarret morën jetën e 84 personave, ka nxjerrë në pah edhe anën humane të shumë personave. I tillë është edhe rasti i Petrit Athanasi, shtetas shqiptar që jeton në Greqi, ka ofruar ndihmën e tij për të prekurit nga zjarri. Shqiptari është pronar i një supermarketi në Greqi, ndërsa është cilësuar nga mediat dhe qytetarët grekë si hero për gjestin e tij human, pasi ka shpërndarë ushqime falas. Në një lidhje telefonike për "News 24", Athanasi tha se gjesti i tij është diçka e vogël përballë një situatë të rëndë në zonat e prekura nga zjarri. "Situatë e rëndë, ndihmat janë gjëja më e vogël. Furnizoj furgona e makina me ushqime. Do vazhdoj t'i ndihmoj njerëzit në Greqi, pasi është diçka e vogël në krahasim me atë që ka ndodhur. Kur djali im luan me fëmijët aty, s'mund t'i la pa i ndihmuar", tha shqiptari.



PETRIT ATHANASI

Gjesti im është diçka e vogël përballë një situatë të rëndë në zonat e prekura nga zjarri. "Situatë e rëndë, ndihmat janë gjëja më e vogël. Furnizoj furgona e makina me ushqime. Do vazhdoj t'i ndihmoj njerëzit në Greqi, pasi është diçka e vogël në krahasim me atë që ka ndodhur.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Riza aktor.
- Një fjalë si hijë.
- Një mund të jetë diplomatik.
- Premton të bëhet as.
- Janë felinë... të zinj.
- Ami i Maupassant.
- Heroi i Emilio Salgarit.
- Qe anarkist i famshëm rus
- Një mungesë gjaku.
- Susanna shkrimtare
- Të parat në cilësi.
- Mbyllin një shtëpi.
- Mbeten në fund.
- Qendër në kaos.
- Ka brrirë piktoreskë një i tillë
- Inicialet e Camus.
- Motra... e Kolë Idromenos
- Një konfuzion total.
- Rastet pa set.
- Rastisin në krye.

- Fillojnë detyrën.
- Bektashi këngëtare.
- Andrea aktore.
- Sampras i tenisit.
- Shkroi Korbi (indic).
- Triolet e Trëndafilë me kredi.
- Kilmer aktor.
- Në krye të robotëve.
- Unë dhe ti.
- Një mund të jetë fetar.
- Stephane poet francez

VERTIKAL

- Fillojnë praktikën.
- Britma e Arkimedit.
- Ekstreme në trap.
- Në fund të fundit.
- Janë fjetoret e ushtarëve
- Parker regjisor.
- Vivaldi kompozitor.
- Një shkop për karambol.
- Janë firmat rentiere.
- Një i fundit mbi të gjithë
- Kufizojnë tatimet
- Janë nomadë.
- Panik pa kufij.
- Fryn detin
- Sidney regjisor i Serpico.
- Jep alarmin.
- Fillojnë nazet.
- Janë llogari.
- Alan regjisor.
- Roman regjisor.
- Eshtë X ajo e sulmit.
- Kapen të parat.
- Një provë... inteligjence.
- Një markë lap top.
- Fillojnë matjet.
- Rruga e Ferenc Molnar.
- Qerre pa qe.
- Fillojnë lirinë.
- Fillojnë vallen.
- Në mes të dhomës.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- Një doktor... i Fritz Lang
- U paraprinë hoteleve.
- Kush nuk ka... nuk ha
- Eshtë djall
- Një mund të ketë i rrallë.
- Ishin perëndi të Samotrakias.
- Institucione Botuese Autonome.
- Eshtë infeksion në bark
- Fundi i një samurai.
- Një markë kafeje.
- Mbyllin një hark.
- Mund të jetë emërore.
- Ishite muzikanti që nuk përsriste.
- Në krye të avokatëve.
- Qerre pa qe.
- Një pjesë e adoleshentëve.
- Një banor imagjinar i planetit të kuq.
- Nuk shuhej dot nga Tantalit.


- Desnuda e Goya-s.
- Ruhet ajo sportive.
- Vetëvrasia e samurait.
- Drita pa kufizj.
- Eshtë yll i skuadrës.
- I dashuri i Aidas.
- Eshtë zhurmë
- Ishite lulja e harresës.

VERTIKAL


- James, armiku i Sherlock Holmes.
- Eshtë edhe ajo saudite.
- Imami aktore
- I kanë çift turket.
- Inicialet e Seagal aktor.
- Eshtë dëshmore... çudibërëse.
- Në fund të lutjes.
- Eshtë sporti me stil të lirë.
- Mbeten në fund.
- Eshtë rasti i veçantë, karakteristik.
- Conan ai i Schwarzenegger.
- Gjysmë ditari.
- Mario, që qe bomber argjentinasi.
- Mund të prishej nga një... kleçkë.
- Në hyrje të pistës.
- Një numër... femrash.
- Eshtë qyteti i Besës.
- Qyteti që quhej edhe Sebaste.
- Njëllotj për latinët.
- Mund të bëjnë stil të lirë.
- Damon aktor.
- Eshtë pije e jona.
- Në krye të noterëve.
- Film i Robert Altman.
- Skuadra merengue.
- Një pjesë e hasmërisë.
- Rrallë është përgjysmë.
- Nisur pa kufij.
- Fillojnë mobilizimin.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| T | O | K | A | T | I | L | U | F | R | A | N | Z |
| A | R | E | S | F | I | N | M | A | R | A | T | A |
| L | I | N | V | E | N | T | I | L | A | T | O | R |
| T | E | R | R | O | R | I | S | T | H | E | T | |
| J | T | E | R | R | O | R | I | S | T | H | E | T |
| A | S | A | M | A | R | A | R | S | | | | |
| H | L | O | R | E | N | M | A | R | A | T | | |
| H | A | M | E | S | I | P | A | R | E | T | | |
| U | R | I | T | H | S | M | K | A | T | N | | |
| I | F | R | O | I | D | E | T | A | V | O | | |
| M | E | N | T | E | K | A | S | A | R | | | |
| M | E | N | T | E | S | H | E | T | A | T | | |
| M | A | H | L | E | R | K | R | N | O | T | A | |
| I | N | E | S | A | K | O | D | T | E | N | | |
| S | T | R | S | E | N | D | E | R | E | T | | |
| T | E | A | P | E | N | D | I | M | I | A | I | |
| E | N | M | E | N | D | I | M | I | S | G | | |
| R | A | A | C | E | T | E | V | E | L | O | | |
| I | T | R | I | Z | A | N | A | K | I | N | | |
| O | A | K | A | T | S | A | R | N | A | | | |
| Z | A | B | E | L | M | I | M | E | D | | | |
| E | M | E | G | A | T | O | N | T | O | R | | |
| T | O | K | A | L | N | D | E | R | A | | | |
| P | A | L | A | D | I | N | E | S | T | O | P | |

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|--|---|---|
| 1 | | | 3 | 2 | 8 | | | |
| | | | 5 | | | | | |
| | 8 | 2 | | | | | | 5 |
| | 9 | 2 | 8 | | | | 1 | 4 |
| 4 | 1 | | 9 | 6 | | | | |
| 6 | | | | | | | 3 | |
| | | | | 7 | 9 | | | |
| | 4 | | 6 | | 1 | | | |
| | 3 | | 4 | | | | | |

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | 2 | 4 | 3 | 6 | 7 | 1 | 9 | 8 |
| 3 | 1 | 6 | 9 | 8 | 4 | 7 | 2 | 5 |
| 7 | 8 | 9 | 5 | 1 | 2 | 3 | 4 | 6 |
| 1 | 3 | 7 | 2 | 5 | 8 | 4 | 6 | 9 |
| 4 | 9 | 2 | 1 | 3 | 6 | 8 | 5 | 7 |
| 6 | 5 | 8 | 7 | 4 | 9 | 2 | 1 | 3 |
| 8 | 6 | 5 | 4 | 7 | 1 | 9 | 3 | 2 |
| 9 | 7 | 1 | 6 | 2 | 3 | 5 | 8 | 4 |
| 2 | 4 | 3 | 8 | 9 | 5 | 6 | 7 | 1 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- "Nga njëherë keni nevojë për tu larguar nga vetja për të parë gjërat më qartë."
- Të mençurit flasin, sepse kanë diçka për të thënë. Budallenjtë flasin, sepse diçka duhet të thonë."
- Njohuria është krenare që di aq shumë.
- Mençuria ka turp që nuk di më shumë.
- Nuk është e mundur të jesh i lumtur pa qenë i mençur, i ndershëm dhe i drejtë. As të jesh i mençur, i ndershëm dhe i drejtë, pa qenë i lumtur.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|---|----|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | 2 | 9 | 13 | 11 | 7 | 2 | 1 | 11 | 2 | 7 | K | O | D | I | A | D | P | A | L | | | | |
| 4 | 9 | 12 | 4 | 11 | 2 | 14 | 13 | 15 | 8 | 2 | A | R | E | S | T | I | S | M | L | A | | | |
| 1 | 12 | 4 | 2 | 12 | 4 | 11 | 6 | 1 | 8 | N | A | D | H | E | R | E | T | I | K | E | T | | |
| 4 | 11 | 2 | 5 | 10 | 3 | 1 | 15 | 12 | 2 | I | R | M | O | N | I | T | O | R | I | | | | |
| 7 | 4 | 12 | 5 | 10 | 3 | 4 | 6 | 1 | 7 | 2 | 12 | B | K | A | P | I | T | A | L | I | S | T | E |
| 3 | 5 | 10 | 3 | 1 | 14 | 4 | 6 | 1 | 1 | A | L | A | P | S | A | T | A | A | T | | | | |
| 4 | 12 | 2 | 5 | 1 | 7 | 2 | 12 | 11 | 4 | 3 | L | E | A | E | T | L | M | T | I | | | | |
| 7 | 10 | 6 | 10 | 14 | 4 | 8 | 12 | 10 | 7 | 4 | I | S | R | E | I | N | E | T | I | M | | | |
| 12 | 11 | 1 | 9 | 4 | 12 | 6 | 8 | 15 | 8 | P | I | S | S | O | D | A | M | O | | | | | |
| 1 | 12 | 12 | 15 | 12 | 15 | 1 | 12 | 1 | 14 | S | E | K | R | E | T | L | G | O | L | | | | |
| 7 | 2 | 14 | 4 | 12 | 7 | K | P | O | S | H | 3 | A | L | E | L | O | N | D | R | A | R | O | |
| 4 | 12 | 1 | 7 | 9 | 4 | 7 | 9 | 4 | 11 | 4 | 12 | T | E | T | A | B | D | E | R | A | E | G | |

Thënie të mençura

- Ndershmëria është kapitulli i parë në librin e mençurisë.
- Kush duket i mençur midis budallenjve, duket budalla midis të mençurve.
- Është më lehtë t'i bësh keq një njeriu të mirë, se sa t'i bësh mirë një njeriu të keq.
- Statistikat janë si minifundet. Ato tregojnë shumë, por fshehin thelbin.
- Askush nuk është aq i pasur që të mos ketë nevojë për një buzëqeshje. Dhe askush nuk është aq i varfër që të mos mund ta jap!

